

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7796 E diel 17 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Uduk si një lajthitje post-Shën Valentini, deklarata e 15 shkurtit e Elisa Spiropalit në emisionin "Provokacija". Ajo tha se PS-ja është e gatshme të ...
Vijon në faqen 21

Nga ERL MURATI
Një protestë e sakrifikuar në altarin e "17 majit"


Opinion *i* **Ditës**
Në trazirat e vitit 1997 dhe dy vjet më pas nga armatosja e popullsisë, humbëm 3 mijë jetë. Më 15 mars 2007 nga shpërthimi i papritur në një fabrikë çmontimi ...
Vijon në faqen 22

Nga FATOS ÇOÇOLI
Shuplaka që nuk erdhi nga studentët




"Policia bëri dallimin e madh, respekt"

Edi Rama, tubim në Vlorë: Opozita, rrumpallë e rrënim për Shqipërinë

Braçe: Donin pushtet me dhunë. SHBA, BE dhe OSBE: Autorët të mbajnë përgjegjësi

Kreu i qeverisë ka ironizuar dje aktet e dhunës nga ana e protestuesve të opozitës ndaj institucionit të Kryeministrit dhe në mënyrë të veçantë ndaj dy veprave artistike që gjenden në hyrje të saj. Nga Vlorë ku ai mbajti një "antimiting", kryeministri Edi Rama ka zgjedhur që reagimet e tij ndaj protestës së opozitës t'i bëjë nëpërmjet disa postimeve në rrjetet ...
Në faqet 5-6

PROTESTA/ 19 VETA TE LENDUAR. BASHA: S'NDALEMI DERISA TE IKE RAMA FLAKE DHE GAZ LOTSJELLES, MIJERA PARA KRYEMINISTRISË

Shkatërrohen skelat mbrojtëse, thyhen xhamat dhe prishet "kërpudha" në oborrin e zyrës së Ramës. Policia qëllon me plumba gome. Në mbrëmje, 20 të shoqëruar për dhunë



(Në foto) Protesta e djeshme e opozitës

Në faqet 2-4

ARRESTOHET OFICERI
Lirimi i trafikantit nga Kosova, në kërkim shefi i komisarariatit në Kukës
Në faqen 12

MBIVENDOSJET
Ligji i pronave prek ndërtimet pa leje, si zgjidhet konflikti mes palëve pretenduese
Në faqen 8

ISH-USHTARI I UÇK
Ramë Lahaj, tenori i njohur shprehet kundër prekjës së kufijve të Kosovës
Në faqen 11

"MILOSAO"
Nikollë Kaçorri përballë mbretit të Hungarisë, Franc Jozefi I
Suplement

Përfituesit e kështit të tretë të dëmshpërblimit, lista e re e trashëgimtarëve

Të përndjekurit, 1 mijë emrat që marrin paratë

Publikohen të dhënat për dosjet, 10 ditë afat për të plotësuar dokumentet

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentet që u mungojnë në dosje për të mos humbur të drejtën për të marrë paratë. Fëmijët e ish-të dënuarve poli-

tikë kanë edhe 10 ditë kohë për plotësimin e dokumentacionit. Burime zyrtare nga Ministria e Financave bëjnë të ditur se janë mbi 1000 trashëgimtarë të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të cilët duhet të plotësojnë dosjet për të filluar pagesat e kështit të tretë.



Sipas të njëjtave burime, mësohet se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve. Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën ...
Në faqet 9-10

PROTESTA OPOZITA

HETIMET

Pas protestës së djeshme të opozitës, policia dhe prokuroria kanë nisur hetimet për identifikimin e personave që kryen akte të dhunshme. Sipas bluve, janë shoqëruar dhe marrë në pyetje mbi 20 persona, mes të cilëve dhe ish-kreu i Policisë Bashkiake, Florenc Hoxha, i cili dyshohet për nxjitje të dhunës.

ARMËT E GARDES

Garda e Republikës brenda godinës së Kryeministrit dhe në tarracë iu është përgjigjur protestuesve me gaz lotsjellës dhe plumba gome. Mësohet se ky gaz lotsjellës të njerëzit e shëndetshëm nuk ka efekte, pasi kalon për 20 minuta.



Sulmi i protestuesve në Kryeministri

Policia nis hetimet, shoqërohen mbi 20 persona. Mes tyre edhe Florenc Hoxha

TIRANË

Mijëra qytetarë nga rrethet e ndryshme të vendit morën pjesë ditën e djeshme në protestën e thirrur nga opozita e bashkuar që prej më shumë se një muaji për të rrëzuar kryeministrin Edi Rama dhe për t'i hapur rrugë krijimit të një qeverie tranzitore, që do të përgatisë vendin për zgjedhje të parakohshme parlamentare. Partitë opozitare e nisën tubimin në orën 11:00 në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Protesta nisi me lule për efektivet e policisë, por u përshkallëzua në dhunë dhe me përplasje me Policinë e Shtetit. Tubimi i planifikuar të ishte paqësor u shndërrua në pak minuta në një sulm me mjete të forta ndaj godinës së Kryeministrit. Protestuesit hodhën kapsolla, bidonë me ujë, tymuese, bomba molotov dhe sende të tjera, ndërsa shkatërruan skelat mbrojtëse dhe i vendosën flakën disa herë hyrjes së Kryeministrit. Gjithashtu, protestuesit shkatërruan edhe instalacionin e kërpudhës së vendosur në lulishten e godinës. Ndërkaq, policia dhe Garda e Republikës kanë reaguar duke sprapsur protestuesit. Burime zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Bënë me dije se nga përplasja mes pjesëmarrësve në protestë dhe efektiveve blu janë lënduar në total 19 persona. Sipas këtyre burimeve, 9 nga të lënduarit janë punonjës të policisë, 2 përfaqësues të medias dhe 8 protestues. Ata kanë marrë në kohë ndihmën mjekësore, fillimisht nga ekipet e terrenit të mëtejshëm në 3 spitalet universitare të Tiranës. Pasi kanë marrë trajtimin mjekësor, personat e lënduar kanë lënë spitalin dhe janë në gjendje të mirë shëndetësore. E ndërsa vijonte sulmi mbi godinën e Kryeministrit,

5 orë sulm me flakë e bomba molotov mbi Kryeministrinë, MSH: U lënduan 19 persona

Protestuesit shkatërruan skelat mbrojtëse e thyen xhamat, Garda kundërpërgjigjet me gaz lotsjellës



ka reaguar ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, i cili përmes një statusi në "Twitter" u bëri thirrje drejtuesve politikë që të distancohenin nga dhuna. "U bëj thirrje gjithë drejtuesve politikë që të distancohen nga dhuna që po ushtrohet ndaj institucioneve të Shqipërisë. Ptoq qytetarët të distancohen nga elementët e dhunshëm. Është me shumë vlerë të dëgjohet zëri i arsyeshem i miqve të mëdhenj të Shqipërisë. Jo dhuna, por arsyeja na afron drejt Europës së vlerave tonat!", - shkruan Lleshaj.

Protesta më e madhe në gjashtë vitet e fundit, ku PD është në opozitë u përmbyll pas 5 orëve mes flakëve dhe tymit. Ndërsa, policia dhe prokuroria kanë nisur hetimet për identifikimin e per-

sonave që kryen akte të dhunshme gjatë protestës, duke dhunuar pronën publike. Deri më tani raportohet për 20 persona të shoqëruar, mes të cilëve dhe ish-drejtori i policisë bashkiake, Florenc Hoxha. Ky i fundit dyshohet për nxjitje të dhunës.

DHUNA NË PROTESTË

1 mijë e 500 forca policie ishin dje në gatishmëri në të gjithë perimetrimin e Kryeministrit. Ajo që u vu re në radhët e policisë është fakti se në protestën e djeshme pati një prani më të vogël të efektiveve femra në krahasim me tubimet e mëherëshme, kjo edhe për shkak të incidentit të ndodhur me Ina Nukën në protestën e banorëve të "Unazës së Re", përballë parlamentit. Anash dhe pas Kryeministrit ishin në

gatishmëri edhe efektivetë të forcave RENE, ndërkohë që autobondat të forcave speciale u stacionuan pranë ish-hotel "Dajtit", me prezencë edhe të Forcave të Ndërhyrjes së Shejtit. Të parët që u përballën me presionin e turmës ishte gardhi para godinës së qeverisë. Ishte ky moment kur drejt Kryeministrit u hodhën disa tymuese dhe bomba molotov. Disa prej protestuesve që arritën të çanin kordonin nisën të hiqnin mbulesën e vendosur në tendën para godinës. Më pas ata goditën me sende të forta xhamat e blinduar të Kryeministrit, duke arritur t'i thyejnë. Protestuesit provuan të gjitha mënyrat për të hyrë në Kryeministri. Ata u vendosën flakën pemëve para godinës, ndërsa shkatërruan

edhe kërpudhën e famshme. Nisur nga situata e krijuar, policia e vendosur nga brenda nisi të hedhë ujë drejt protestuesve, ndërsa përdori edhe gaz lotsjellës. Hedhja e gazit lotsjellës e detyroi shpeshherë turmën të tërhiqej, por pas disa minutash, protestuesit vijuan sulmin ndaj dyerve të Kryeministrit. Shumë prej protestuesve pësuan asfiks. Ata në gjendje më të vështirë u transferuan me ambulancë drejt spitalit. Protestuesit janë përballur me një situatë të rëndë për shkak të gazit lotsjellës. Në krah të Kryesisë së Kuvendit, një prej protestuesve është shtrirë për tokë pa ndjenja, ndërsa protestues të tjerë kanë shpejtuar që t'i japin ndihmë. Ndërkaq, jo më pak tronditëse ishte pamja e protestuesve të tjerë të ulur në bordurë me kokën ndërduar, teksa fshinin sytë për shkak të gazit lotsjellës. Në përfundim të protestës së djeshme është parë në sheshin para Kryeministrit dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, i cili ka takuar e përgëzuar nga afër policët që formuan kordonin mbrojtës. Ndërsa për gazetarët ka komentuar shkurt: "Policia ka bërë detyrën dhe vetëm detyrën".



Protesta e djeshme e opozitës në Tiranë

Protesta, Lleshaj: Armën tonë kemi durimin

TIRANË - Pak pas vendimit të opozitës së bashkuar për t'i dhënë fund protestës, ka reaguar edhe ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj. Përmes një postimi në "Twitter", Lleshaj shkruan se reagimi i Policisë së Shtetit në lidhje me protestuesit është një mënyrë për t'i dalluar ata. Ministri Lleshaj nuk kursen edhe falënderimin për Policinë e Shtetit.

POSTIMI

"Sot ne bëmë dallimin e qartë mes atyre që protestave u përgjigjeshin me zjarrin e armëve luftarake dhe nesh, që armën tonë kemi durimin e zjarrin tonë kemi përkushtimin për Shqipërinë europiane! Faleminderit nga zemra policisë shqiptare. Super punë sot, mirënjohje!"



Policë me kundërgaz dje në protestë



Protesta 5 orë para godinës së qeverisë, gaz lotsjellës dhe plumba gome drejt protestuesve

Protesta, mijëra në shesh, orët e tensionit te Kryeministria

Detajet, nisi me lule dhe përfundoi me dhunë

Tardhur nga çdo qytet i Shqipërisë, mijëra qytetarë shprehën dje revoltën e tyre kundër qeverisë përmes rezistencës prej 5 orësh përpara Kryeministrit. Pikërisht zemërimin e tyre e shfrytëzoi para derës së kësaj godine tekta e goditën me skela, tulla e gurë e madje u tentua t'i vihet flaka. Protesta nisi me lule, por dhjetëra protestues përfunduan në spital për shkak të problemeve shëndetësore të krijuara nga gazit lotsjellës i hedhur nga forcat e Gardës së Republikës. Përgjatë protestës nuk munguan përleshjet, gazit lotsjellës, uji me presion dhe bombat molotov, ndërkohë që nga protestuesit u përdorën sende të forta, gurë e shufra hekuri, që u shkulan nga skela para Kryeministrit. Nga brenda Kryeministrit, policia iu përgjigj me gaz lotsjellës protestuesve. Nuk mungoi as flaka në dyert e Kryeministrit, ndërkohë që nga brenda godinës shuheshin flakët. Policia me megafon lajmëronte se veprimet e protestuesve përbëjnë vepra penale dhe se do ndëshkoheshin nga ligji. Ndërkohë, u dëmtua edhe instalacioni i kërpudhës, vepër e një artisti të huaj. Drejtuesit e opozitës qëndruan gjatë gjithë kohës në mes të protestuesve dhe ashtu siç ishte paralajmëruar, ata nuk mbajtën fjalime politike, pasi sipas tyre, protesta ishte e qytetarëve. Që herët lideri i opozitës, Lulzim Basha, u bëri thirrje qytetarëve që të qëndrojnë të bashkuar dhe të ruajnë qetësinë përballë çdo provokimi. Por, të shpeshta ishin momentet kur disa protestues goditën me gurë xhamin e derës së Kryeministrit.



derës së Kryeministrit. Po kështu, nga tarraca qëllohet me gaz lotsjellës, me qëllim që protestuesit të sprapsen. Protestuesit hipën në shkallët e Kryeministrit dhe pasi dëmtuan mburojtë, tentuan të hyjnë në godinë. Nga brenda saj drejt protestuesve është hedhur me zorrë ujë. Shumë persona u lënduan, ndërkohë që forca speciale u panë në tarracën e Kryeministrit tek sa vëzhgonin çdo detaj në protestë. Në një moment, policia u tërhoq dhe PD-ja e akuzoi se ishte e qëllimshme. Shumë protestues u ndjenë keq nga gazit lotsjellës, ndërkohë që autoambulancat mbërritën në shesh për të marrë personat e lënduar. Garda e Republikës qëlloi me plumba gome dhe gaz lotsjellës nga tarraca e Kryeministrit në drejtim të protestuesve, të cilët kanë kordonin e policisë dhe i mësynë kryeministrin. Përgjatë 5 orëve rezistencë në shesh, qytetarët shprehën revoltën për probleme si varfëria, papunësia apo detyrimi i fëmijëve për t'u larguar jashtë shtetit. Në protestën e djeshme gjetën vend edhe grupe qytetarësh, që mbrojnë kauza specifike e që protestojnë prej kohësh, si banorët e "Astirit" apo qytetarë të Fierzës. Por, protesta nuk kaloi pa incidente, ndërkohë që pati shumë të lënduar. Opozita akuzoi kryeministrin Edi Rama dhe policinë se provokoi protestuesit. Vetë Rama nuk ndodhej në Kryeministri, por udhëtoi drejt Vlorës dhe opozita e quajti takimin si antimiting. Protesta e nisur prej orës 11:00 para Kryeministrit u mbyll në orën 16:00 me fjalën e kryetarit të PD-së.

PROTESTA NË MINUTA, ÇFARË NDODDHI PËRGJATË 5 ORËVE NË BULEVARD

- Ora 11:10** - Protestuesit mblihen para Kryeministrit.
- Ora 11:15** - Basha dhe Kryemadhi mbërrin në sheshin përballë Kryeministrit.
- Ora 11:30** - Kordonit i policisë çahet dhe protestuesit mësynë skelën me të cilën ishte mbuluar neoni dhe tentojnë hyrje në Kryeministri.
- Ora 11:45** - Forcat e policisë dhe të Gardës së Republikës nga brenda Kryeministrit hedhin ujë dhe gaz lotsjellës. Protestuesit largohen nga dera e Kryeministrit.
- Ora 11:57** - Protestuesit rikthehen sërish në hyrje të Kryeministrit dhe me mjete të forta tentojnë të çajin xhamat e blinduara të derës.
- Ora 11:58** - Kryeministri Edi Rama mbyll antimitingun në "Sheshin e Flamurit", në qytetin e Vlorës.
- Ora 12:03** - Mbërrinë makinat e ambulancës, të cilat transportojnë të lënduarit nga gazit lotsjellës. Raportohet për 6 të lënduar.
- Ora 12:04** - Reagon kryetari i PD "Kordonit i policisë u çaq qëllimisht. Ky ishte plani i Edi Ramës për të shkakuar dhunë".
- Ora 12:09** - Një nga protestuesit që ka hipur sipër skelës që mbulon neonin është i bie gjendje të fikt. Protestuesit e tjerë i japin ndihmë.
- Ora 12:18** - Lëshohet sërish gaz lotsjellës në drejtim të protestuesve, që gjendeshin në hyrje të Kryeministrit.
- Ora 12:28** - Protestuesit hipin nëpër shtyllat që gjenden në bulevard dhe shkëpusin altoparantët e policisë.
- Ora 12:32** - Reagon kryeministri Edi Rama për protestën nëpërmjet postimit të dy fotove, një nga takimi në Vlorë dhe një nga protesta në Tiranë.
- Ora 12:40** - Protestuesit çajnë sërish kordonin duke lëshuar thirrje: "Futini brenda", "Rama lk", "Liri Demokraci".
- Ora 12:43** - Protestuesit vërshojnë edhe në pjesën e majtë të Kryeministrit dhe tentojnë të rrezojnë skelën që mbulon "Kërpudhën".
- Ora 12:45** - Policia dhe Garda lëshojnë sërish, kësaj here nga tarraca e Kryeministrit, gaz lotsjellës në drejtim të protestuesve.
- Ora 12:55** - Policia vendos një kordon të dytë në hyrje të Kryeministrit për të mos lejuar protestuesit të hyjnë.
- Ora 12:58** - Reagon sërish Basha: "Protesta është në dorë të qytetarëve, të qëndrojnë të bashkuar".
- Ora 13:05** - Reagon Lleshaj dhe u bëri thirrje drejtuesve të opozitës të distancohen nga dhuna.
- Ora 13:14** - Protestuesit çajnë sërish kordonët e policisë dhe mësynë sërish të hyrja e Kryeministrit dhe policia i përgjigjet prapë me gaz lotsjellës.
- Ora 13:17** - Disa nga protestuesit e marrin kundërgazet disa punonjësve të policisë dhe i vendosin vetë.
- Ora 13:19** - Reagon Ambasada e SHBA dhe bëri thirrje palëve për vetëpëmbajtje.
- Ora 13:25** - Një protestues tenton të thyjë xhamat e dyerve në katin e dytë dhe policia nga tarraca hedh sërish gaz lotsjellës.
- Ora 13:40** - Protestuesit rrezojnë plotësisht skelën që mbulon "Kërpudhën" në anën e majtë të Kryeministrit.
- Ora 13:45** - Reagon Berisha: "Kjo protestë është fundi politik i Edi Ramës. Nëse nuk e kupton mesazhin, do zvarritet".
- Ora 13:53** - Reagon LSI: "Policia dhe Garda kanë përdorur lëndë helmuese dhe kanë provokuar protestuesit".
- Ora 15:09** - Protestuesit i vënë flakën rrjetës që mbulon skelën dhe tentojnë sërish të çajin derën në hyrje të Kryeministrit.
- Ora 16:00** - Mbyllet protesta.

QELLIMI

Prej më shumë se një muaji, partitë opozitare kanë thirrur shqiptarët në protestë, në kryeqytet për të rrëzuar kryeministrin Rama dhe për t'i hapur rrugë krijimit të një qeverie transitore, që do ta përgatisë vendin për zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe që sipas opozitës, do t'i hapë vendit rrugën e integritimit.

AKUZA

Deputeti i PD-së, Tritan Shehu, e cilësoi dje reagim ekstrem, veprimin e policisë për të hedhur gaz lotsjellës gjatë protestës. "Prokuroria duhet menjëherë të fillojë hetimet për reagimin ekstrem të policisë me gazet toksikë të përdorur sot (dje) në shkallë të gjerë", tha z. Shehu.

DENONCIMI

Deputeti i PD-së, Ervin Saliqij, mendon se nga protestuesit nuk u ushtrua dhunë, përkundrazi ata u dhunuan. Ai akuzon se policia abuzoi me përdorimin e gazit lotsjellës, duke sjellë pasojë të të lënduarit. "Përdorimi i Gazit lotsjellës i cili sipas ekspertëve klasifikohet në lëndët kimike luftarake të lehta, por me pasojë", tha Saliqij.

Pemë të shkullura, xhama të thyer, goditje të herëpashershme me sende të forta,

ndërkohë që vazhdimisht hidhej ujë për të sprapsur protestuesit sa herë që i afroreshin

OPOZITA VENDIMI

KONFRONTIMI

Disa deputetë të opozitës shkuan mbrëmë në Drejtorisë së Policisë së Tiranës, me synim për të zhvilluar një takim me kreun e kësaj drejtorie për arrestimet e bëra pas protestës. Por, aty pati një konflikt mes deputetit Flamur Noka dhe policëve. "Kupola e policisë, si tufë derrash duke u zhgëryer mbi vodka dhe uiski na lanë një orë këtu pa dhënë asnjë përgjigje", tha z.Noka.

KOLEGJI

Pasi deklaroi mbylljen e protestës dhe paralajmëroi një tjetër të enjten, kreu i PD-së, Lulzim Basha mbledhi mbrëmë kolegjin e kryetarëve të degëve. Qëllimi i mbledhjes ishte përgatitja për një tjetër protestë para parlamentit, me përmasa të njëjta me atë të djeshmen para Kryeministrisë.



Përplasja përpara Kryeministrisë

Basha mbledh aleatët: Nuk ndalemi derisa të ikë Rama, revolta qytetare vazhdon

Valentina Madani

Opozita sërish në shesh, ditën e enjte protestë para Kuvendit

"Rama hapi kordonin e policisë për të nxitur dhunën"

Pas rezistencës prej 5 orësh në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", opozita e bashkuar përmes një mbledhjeje urgjente vendosi vazhdim e protestës deri në largimin e kryeministrit Edi Rama. Kreu i PD-së, Lulzim Basha, mes turmës së protestuesve i ftoi qytetarët në një tjetër protestë ditën e enjte, në orën 10:00, përpara parlamentit, sikurse tha ai, për të vazhduar kryengritjen e tyre. "Sot (dje) qdokush e ka parë forcën e qytetarëve të bashkuar, të vendosur për të mos pranuar më një kryeministër dhe qeveri të kapur në vjedhje flagrante. Dua në emër të opozitës t'ju shpreh mirënjohjen më të thellë! Kjo kryengritje qytetare do të vazhdojë. Të enjten në orën 10:00 në protestën tjetër, më të bashkuar se kurrë. Ne u bashkuam këtu për qëndresë të vendosur. Derën e Kryeministrisë e bllokoim me duart e tij dhe nga ajo derë as nuk do të hyjë më dhe as nuk do të dalë më", u shpreh Lulzim Basha. Pas njoftimit për mbylljen e protestës, qytetarët e shumtë u shpërndanë për t'u rikthyer në protestë ditën e enjte para parlamentit. Më herët kreu i opozitës akuzoi se protestuesit nuk shkuan në sheshin para Kryeministrisë për të ushtruar dhunë, por u provokuan nga policia. Për kryetarin e PD-së, kërkesa politike është krijimi i një qeverie teknike. "Është thirrur nga opozita me një qëllim politik, qeveri transitore, zgjedhje të parakohshme, t'i japim fund qeverisë që është kapur në vjedhje tek 'Unaza', është kapur në vjedhje te Teatri, është kapur në vjedhje të votave. Asnjë protestues nuk erdhi për të kryer akte dhune, ju e dini fare mirë sesi organizohen protestat e dhunshme. Asnjë prej protestuesve këtu nuk erdhi për të kryer akte dhune. Ata u provokuan dhe u nxitën nga një skenar i mirëmenduar i Edi Ramës dhe i ekzekutuar nga një grusht policësh të korruptuar dhe të lidhur me krimin", theksoi z.Basha. Kreu i opozitës akuzoi se për shkak të skenarit



QËNDRESA

Kreu i opozitës gjatë gjithë kohës qëndroi mes protestuesve, duke i inkurajuar ata që të vazhdonin qëndresën. Basha u pa me sy të skuqura për shkak të gazit lotsjellës, që u përhap shumë herë gjatë protestës. Garda e Republikës ka përdorur gazin lotsjellës në momentet që turma po sulmonte derën kryesore të godinës së qeverisë.

ogurzi, gjendja ka dalë jashtë kontrollit. "Kordoni i policisë u çap pas një përpjekjeje fare të lehtë të banorëve të 'Unazës'. Kordoni i policisë u çap që të përdorë dhuna dhe gazi lotsjellës. Këto blegërime që dëgjonim janë pjesë e një skenari kriminal të Edi Ramës për të shkakuar një gjendje të tillë. Protestuesit kishin ardhur për të demonstruar

paqësisht, pa dhunë, në qendër të sheshit po flisnin qytetarët. Për shkak të skenarit të tyre ogurzi, gjendja ka dalë jashtë kontrollit dhe nuk duket asnjë polic askund. Nuk marrin asnjë kontakt me organizatorët e protestës, por vazhdon t'i fryjë skenarit të përplasjes dhe dhunës me këto mesazhe idote. Policia nuk po zbaton ligjin, policia e ka thyer ligjin", u shpreh z.Basha.

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka, shkruan në "Facebook" se protesta nuk ka mbaruar dhe se ajo vetëm sa ka filluar. "Se mos mendon se mbaroi... Vetëm sa ka filluar qelbësirë!", deklaroi z.Paloka.



SHKURT

Kryemadhi, mesazh Ramës: Ky është vetëm fillimi, nuk ke parë gjë akoma

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, nga selia e partisë i dha një tjetër mesazh kryemnistrit të vendit, Edi Rama. Ajo tha se ndonëse ai u largua nga Tirana, ajo që pa dje përmes TV-së është vetëm fillimi. "Sot (dje) ishte vetëm fillimi i atij reagimi qytetar. Na bënë të ndjehemi krenarë për atdheadashurinë që shqiptarët kanë për vendin e tyre. Sot më shumë burra dhe gra se asnjëherë tjetër ishte protesta që e rrëzoi Edi Ramën për t'i thënë që ai nuk është më kryeministër i shqiptarëve. Kërkonte të bënte antimitingun nga Vlora, por shqiptarët ia dhanë përgjigjen nga ai bulevard. Shqiptarët i tregun: 'Ti ke ikur zotëri, ke ikur si një frikacak', - tha ajo. Kryemadhi zgjodhi një shprehje të përdorur shpesh nga Rama për t'i dhënë atij një tjetër mesazh. "Sot (dje) i treguan se mund të përdorë çdo lloj arme, por nuk i tut dot shqiptarët. Mësimë të tjera e presin. Nuk ka parë gjë akoma. Jo gaz lotsjellës, jo plumba plastikë, po sikur gjithë arsenalin e ish-BSH të përdorë, ai nuk e mund dot popullin e tij. Ditë më të tmerrshme, më me makth do ketë për Edi Ramën", - u shpreh zj.Kryemadhi.

Berisha, Ramës: Jep dorëheqjen, do kesh fundin e Alisë

Për ish-kryeministrin Sali Berisha, protesta shënoi fundin e kaktivitracisë. "Janë të mjerë, të braktisin sa më parë regjimin e kaktivitracisë. Thirrja ime për policët e ndershëm është: Bashkohuni me popullin që po demonstroi për gjërat më jetike, mos mbron mbatharakun!", tha z.Berisha, i cili qëndroi gjatë kohës mes protestuesve. Sipas tij, Rama do të ketë të njëjtin fund me Ramiz Alinë. Madje sipas tij, Rama pas kësaj proteste nuk do të mund të kthehet më në Vlorë. "Edi Ramës i them se më 20 shkurt Ramiz Alia të mori me pizhama dhe të çoi në një bunker në Zall-Herr bashkë me bllokmenët e tjerë. Tani i them: Nuk ka kush të çon në bunker, jep dorëheqjen për të mos pësuar fatin e babait tënd shpirtëror, Enver Hoxhës!", theksoi z.Berisha.

Protesta, Bardhi: Pse vendosëm ta mbyllim, hapat e mëtejshëm

Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazmend Bardhi, zbardhi dje arsyet e vendimit të opozitës për ta mbyllur protestën e djeshme. Sipas tij, ky bashkim i shqiptarëve kundër qeverisë "Rama" ka qenë i jashtëzakonshëm dhe u tregoi të gjithëve qëndrimin e popullit shqiptar ndaj drejtuesve të vendit. Ai e bëri të qartë se të enjten, bashkimi popullor në protestën e radhës do të arrijë që ta largojë kreun e ekzekutivit. "Qëllimi i protestës ishte t'u tregonte shqiptarëve dhe botës mbarë që ky është bashkimi më i madh kundër qeverisë së Ramës. Rrëzimi i tij është vetëm fillimi i aksionit tonë opozitar, shumica e shqiptarëve nuk e njohin Ramën si kryeministër. Nuk do ta ndërpresim, do ta vijojmë të enjten në orën 10. Ky është synimi dhe qëllimi i opozitës. Ne do ta rrëzojmë Edi Ramën", deklaroi z.Bardhi për "News 24".



Kryeministri reagoi për shkatërrimin e "Kërpudhës": Kjo nuk është Shqipëria dhe shqiptarët

Protesta, Rama-Bashës: Rrumpallë e rrënim për Shqipërinë që kishim

Kreu socialist vijoi dje në Vlorë turin "Bashkia që duam"

Kreu i qeverisë ka ironizuar dje aktet e dhunës nga ana e protestuesve të opozitës ndaj institucionit të Kryeministrit dhe në mënyrë të veçantë ndaj dy veprave artistike që gjenden në hyrje të saj. Nga Vlorë ku ai mbajti një "antimiting", kryeministri Edi Rama ka zgjedhur që reagimet e tij ndaj protestës së opozitës t'i bëjë nëpërmjet disa postimeve në rrjetet sociale, ku ndër të tjera theksoi se pamjet e dhunës dhe shkatërrimit janë e vetmja gjë që mund të ofrojë opozita. Më konkretisht, ai publikoi një foto të veprës artistike të Carsten Holler dhe pamjeve të shkatërrimit të saj gjatë ditës së djeshme, duke theksuar se ky është dallimi mes asaj që ofron mazhoranca dhe asaj që ofron opozita. "Zgjedhja është e qartë: Mund e durim për Shqipërinë që duam apo rrumpallë e rrënim për Shqipërinë që kishim", - shkroi Rama. Po ashtu, ai nuk nguroi t'i kërkonte falje autorit të saj për imazhet që përcolli kjo protestë, duke theksuar se ajo çka ofroi protesta nuk ishte Shqipëria e vërtetë. "Kërpudha, vepër e Carsten Holler, dhuruar Kryeministrit pas një vizite të tij në vendin tonë, pas së cilës artisti i famshëm bashkëkohor është kthyer në një ambasador të Shqipërisë e të shqiptarëve. Ndjesë Carsten, kjo nuk është Shqipëria dhe shqiptarët nuk janë këta!", - shkroi më tej Rama.

PËR PROTESTËN

Ndërkohë që nëpërmjet një tjetër statusi në rrjetet sociale, kryeministri shtron



PËR PROTESTËN

"Për të gjykuar se kush është ndryshimi mes nesh dhe atyre që janë sot në Tiranë, është ndryshimi mes Vlorës sot dhe Vlorës dje. Ata janë mbledhur për të përsëritur të njëjtin avaz, por sot Vlorë dhe Shqipëria kanë zot", - tha Rama.

te pyetjen nëse faji për atë që ndodhi dje në bulevard dhe para Kryeministrit ishte faji i liderëve të opozitës apo edhe qytetarëve që i ndjekin nga pas. Nga ana tjetër, ai shprehu mirënjohje për rolin që luajtën forcat e policisë, të cilat arritën ta menaxhojnë situatën pa pasur asnjë incident apo të lënduar rënd. Madje, ai theksoi se edhe policia tregoi ndryshimin e madh që ka pësuar në krahasim me atë që ishte pak vite më parë. "Për protestuesit: Është faji i atyre që ju tërheqin nga hunda apo juaji, që akoma i ndiqni pas ata udhëhumbur? Për vlonjatët: Sot ju i ritreguat Shqipërisë

atë që dini më mirë, anën e duhur të historisë! Për Policinë e Shtetit: Ishte dita për të bërë dallimin e madh. Ju e bëtë! Respekt!", shkroi më tej Rama.

ANTIMITINGU

Por, ndërsa opozita ishte mbledhur për të protestuar para Kryeministrit, mazhoranca kishte nisur antimitingun e paralajmëruar në "Sheshin e Flamurit". Në fjalën e tij, kreu i qeverisë, Edi Rama, nga Vlorë tha se aksioni i opozitës vjen për shkak të frikës nga drejtësisë e re, ndërsa siguroi shqiptarët se Shqipëria ka zot. "Nëse çdo shqiptar që ka sy për të parë dhe veshë për të

dëgjuar, dhe mendje për të gjykuar se kush është ndryshimi mes nesh dhe atyre që janë sot në Tiranë, është ndryshimi mes Vlorës sot dhe Vlorës dje. Ata janë mbledhur për të përsëritur të njëjtin avaz, por sot Vlorë dhe Shqipëria kanë zot", - tha Rama. Kryeministri Rama kishte edhe një përgjigje për akuzat e artikuluar nga kryetarja e LSI-së për blerje të votave. "Na tregon ne doktorësja blerjen e votës, nëse ka në Shqipëri një fabrikë që ka blerë votën, dihet se kush është. Ata janë në panik, ata votë nga populli nuk marrin dot dhe kanë hallin tjetër që drejtësia e re po vjen dhe shumë prej tyre do të përgjigjen para drejtësisë", - deklaroi Rama. A thua të ishte një demonstrim force numrash, kreu i qeverisë ka theksuar se mazhoranca ndryshe nga opozita, pa përgatitje fare arriti të mbushte "Sheshin e Flamurit".

SHKURT

Braçe: Sulmi i parapërgatitur, donin të merrnin pushtetin me dhunë

Zëvendëskryeministri Erion Braçe ka akuzuar opozitën se nëpërmjet protestës dhe sulmit ndaj godinës së Kryeministrit kërkoi të marrë pushtetin me dhunë. Sipas tij, sulmi kundër selisë së qeverisë ishte i organizuar, pavarësisht thirrjeve të ndërkombëtarëve për protestë paqësore. "Synimi ishte i qartë dhe banal: marrja me dhunë e pushtetit. Por, nuk na imponohet kush me dhunë, ne kemi agjendën tonë ku prioritet është reforma në drejtësi", - u shpreh zëvendëskryeministri Erion Braçe. Ndërkohë, ai vlerësoi sjelljen e policisë gjatë kësaj proteste, e cila sipas tij tregoi se si mund të menaxhohen protesta të tilla pa qenë nevoja të vriten njerëz. "Policia tregoi se në këtë vend zbatohet ligji edhe pa pushkatuar kundërshtarët në bulevard. Sjellja e policisë në raport me një numër të vogël njerëzish të dhunshëm është një shenjë që në këtë vend zbatohet ligji edhe pa pushkatuar kundërshtarët në bulevard", - deklaroi Braçe.

Leli drejt rikonfirmimit, Rama: Në katër vitet e ardhshme do të bëjmë më shumë

A shtu siç bëri në Korçë me Sotiraq Filon, kreu socialist ka lënë të kuptohet se edhe Dritan Leli do të rikonfirmohet për një mandat të dytë në krye të Bashkisë së Vlorës. Kryeministri Edi Rama u shpreh nga Vlorë se me Dritan Lelin në krye të bashkisë, PS ka bërë më shumë se në të gjitha vitet e demokracisë për Vlorë, ndërsa shtoi se në katër vitet që vijnë do të bëjmë më shumë, duke lënë të kuptohet se do të rikandidohet në zgjedhjet e ardhshme lokale në 30 qershor të këtij viti. "Ne me Dritan Lelin kemi bërë më shumë se në të gjitha vitet e demokracisë. Unë iu siguroj që në katër vitet që vijnë do të bëjmë më shumë se në katër vitet që po përfundojnë. Do të bëjmë për Vlorën, sepse Vlorë ka bërë shumë për Shqipërinë. Edhe sot ka shumë nga ata që nuk kanë ardhur, sepse ne nuk bëmë një muaj përgatitje për të mbledhur njerëz në shesh. Kundërshtarët po u ofrojnë shqiptarëve të njëjtin gjullurdi", - tha Rama.

NDËRKOMBËTARËT REAGIMET

DEKLARATA

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, shprehet se asnjë polic nuk u dhunua dhe të gjithë ata që përfunduan në spital u helmuan njësoj si protestuesit. Sipas tij, protesta e djeshme ishte më e madhja dhe se asnjëherë më parë nuk ka pasur aq shumë njerëz në shesh. Sipas tij, tani duhet caktuar data e zgjedhjeve politike.

MIRËNJOHJA

Për kreun e grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, qytetarët shqiptarë shënuan djehistori, duke mbyllur në çark Edi Ramën. "Qytetarët shkruan historinë dhe mbylljen në çark Edi Ramën, frikacakun e lëngaraqin më të madh, si dhe të korruptuarin që ka vjedhur më shumë këtë vend", - tha Vasili.



Nga protesta e djeshme e opozitës te Kryeministria

Tensionet në protestë, OSBE: Autorët e dhunës do të mbajnë përgjegjësi për incidentet

Protesta, SHBA dhe BE: Jo dhunë, palët të tregojnë vetëpërmbytje

"Mbështesim të drejtën e qytetarëve për të protestuar"

Valentina Madani

Ndërkombëtarët përmes ambasadave të tyre në Tiranë apelojnë për qetësi në protestën para godinës së Kryeministrit. Ambasada amerikane në Tiranë, ajo e Bashkimit Evropian dhe OSBE bënë thirrje për shmangje të dhunës në protestën e opozitës. "Ambasada e Shteteve të Bashkuara dënon me forcë dhunën dhe shkatërrimet që ndodhën gjatë protestave të sotme në Tiranë. Mbështesim të drejtën e qytetarëve për të protestuar paqësisht, por dëmtimi i pronës publike dhe dhuna nuk janë të pranueshme. Nxistim të gjitha palët që të tregojnë vetëpërmbytjen më të mirë dhe të rivendosin qetësinë. Iu bëjmë thirrje të gjitha partive politike që t'i denoncojnë këto akte dhe të ndërmarin të gjitha hapet e nevojshme për t'u siguruar që situata të shndërrohet në paqësore dhe konstruktive", thuhet në reagimin e Ambasadës së SHBA-ve. Për BE-në, e drejta e qytetarëve për të protestuar është një vlerë thelbësore e një demokracie moderne evropiane. "Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe ambasada e Shteteve Anëtare në Tiranë u bëjnë thirrje të gjitha palëve të tregojnë përmbytje të menjshme. E drejta e qyteta-



rëve për t'u shprehur përmes protestës paqësore është një vlerë thelbësore e një demokracie moderne evropiane. Megjithatë, dëmtimi i pronës publike dhe përdorimi i dhunës nuk janë të pranueshme. Ne iu bëjmë thirrje të gjitha palëve të bëjnë çmos për të shmangur dhunën dhe çrregullimin e mëtejshëm", thuhet në reagimin e delegacionit të BE-së në Tiranë. Edhe OSBE u bëri thirrje protestuesve për vetëpërmbytje, duke dënuar aktet e dhunës ndaj Kryeministrit. OSBE shprehet se përshkallëzimi i dhunës është shkeljeje e parimeve të protestës demokra-


tike e paqësore. Ndërsa theksojnë se autorët do mbajnë përgjegjësi për incidentet. "Bëjmë thirrje për përmbytje nga çdo akt dhune i mëtejshëm kundër Kryeministrit dhe çdo lloj prone publike apo private. Përshkallëzimi i dhunës së rrugës sot përbën një shkeljeje të parimeve të protestës demokratike paqësore. Nxistësit dhe autorët e dhunës mbajnë përgjegjësi për incidentet e sotme. (e djeshme). Ne do të vijojmë të mbështetim të gjitha aktet e protestës demokratike dhe paqësore, si pjesë e përkrahjes sonë të palëkundur për demokracinë në Shqipëri", - shprehet në re-

PD: Sa veta janë vrarë në protestat e Parisit?

Ambasada franceze, thirrje protestuesve: Shmangni vandalizmin

Ambasada e Francës në Tiranë u bëri dje thirrje protestuesve që të shmangin provokimet dhe vandalizmit. Sipas saj, e drejta e qytetarëve për shprehjen e pakënaqësisë në një mënyrë paqësore është vlerë qendrore për demokracinë moderne evropiane. "Ambasada e Francës në Tiranë u bën thirrje protestuesve për qetësi dhe të evitojnë provokimet dhe aktet vandale. Sikundër e kemi shprehur bashkërisht me BE-në dhe vendet e tjera anëtare, e drejta e qytetarëve për të shprehur lirish dhe në mënyrë paqësore pakënaqësinë e tyre është një vlerë kyçe për një demokraci evropiane moderne. Dëmtimi i pasurisë publike dhe ushtrimi i dhunës janë të papranueshme. U bëjmë thirrje protestuesve të ndalin menjëherë dhunën dhe të privilegjojnë dialogun", thuhet në reagimin e ambasadës franceze. Por, nënkryetari i PD-së, Edmond Spaho, iu përgjigj indirekt deklaratës së ambasadës franceze në Tiranë, e cila bënte thirrje për të shmangur dhunën. Spaho kujton protestat e dhunshme të "jelekëverdheve" në Paris, që detyruan presidentin francez, Macron të tërhiqte vendimin që sillte rritjen e çmimit të naftës. "Po në Francë përse kanë katër muaj që dëmtojnë pronën publike? A nuk ishte dhuna e protestuesve që detyroi Macronin të mos rrisë çmimin e karburantit si dhe të rrisë pagën minimale? Sa veta janë vrarë në protestat në Paris? Shqiptarët po protestojnë për shoqëri demokratike, zgjedhje të lira e të ndershme, parime të lindura nga revolucioni francez", - u shpreh Z.Spaho.

agimin e saj OSBE. Edhe ambasadori i Britanisë së Madhe bëri thirrje për protestë paqësore. "Ne mbështesim ata që bëjnë thirrje për demonstrata paqësore. Kjo është një kohë



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, dje në protestë

Nishani, mesazh ambasadorëve: Uragani popullor nuk trembet dot

Ish-presidenti Bujar Nishani reagoi për shoqërimin e disa protestuesve nga policia. "Një grup kapuçonës të zinj, ja si e përdorin emrin, forcën, pushtetin e shtetit tek godasin me grushte një person që thonë se po e shoqërojnë në polici. Këta banditë nuk do mund të kishin këtë kurajë prej nazistësh, nëse një kryegangster nuk do të kishte uzurpuar zyrën e qeverisë, pikërisht me ndihmën e këtyre tipave. Nëse opozita nuk kërkon hetimin e këtyre gangsterëve dhe urdhërdhënësve të tyre është në bashkëfajësi", shkruan Nishani. Në fund, ai ka edhe një mesazh për ambasadorët, nisur edhe nga reagimet e tyre gjatë ditës së djeshme. "Zotërinj ambasadorë të huaj, ja këta janë partnerët tuaj në Shqipëri. Uragani popullor i shqiptarëve nuk trembet dot, jo!", - shprehet Nishani.

për të respektuar sundimin e ligjit", deklaroi ambasadori Duncan Norman.

Njoftim për shitje me ankand te III
Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ne date 11.02.2019 ankandin e trete te pasurise te pales debitore Sh "GP R A" sh.p.k. e përbëre nga:
Pasurie Nr. 31/33, ne Z.K.Nr. 2255, volum nr. 5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m2, ne Koxhas, Durres; Ankandi III fillim me çmim fillëstar ne masen 103 077, 09 Euro.
Pasurie Nr. 314, ne Z.K.Nr. 2255, volum nr. 1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12 900 m2, ne Koxhas, Durres; Ankandi III fillim me çmim fillëstar ne masen 189 066,5 Euro.
Pasurie Nr. 31/3, Z.K.Nr. 2255, volum nr. 1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4 300 m2, ne Koxhas, Durres; Ankandi III fillim me çmim fillëstar ne masen 43 022,1 Euro.
Ankandi do te zhvillohet ne date 13.03.2019 ora 15:00 ne seline Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir_dervishaj@yahoo.com. WEB www.powerjustice-al.com

Njoftim për shitje me ankand te III
Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ne date 11.02.2019 ankandin e trete te pasurise te pales debitore Sh "Stati Construction" sh.p.k dhe e pales dorezaneze, e përbëre nga:
"Ate" - me numër pasurie: 112123 ne Zonen Kadastrale Nr. 1522, volumi 3, faqe 249, Ankandi fillim me çmim fillëstar ne masen 2.016.000 leke
"Apartament" - me numer pasurie 1161/1-19 Zonen Kadastrale Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, Ankandi fillim me çmim fillëstar ne masen 957.400 leke
"Apartament" - me numer pasurie 1161/1-20 Zonen Kadastrale Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, Ankandi fillim me çmim fillëstar ne masen 1.713.600 leke
Ankandi do te zhvillohet ne date 13.03.2019 ora 15:00 ne seline Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir_dervishaj@yahoo.com. WEB www.powerjustice-al.com

NJOFTIM ANKANDI
1. Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të III (tretë), për shitjen e pasurisë ULLISHITE , me sip.3.400 m², Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Sefer Skraqi. I datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillëstar në vlerën **1.713.600 (një milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) Lekë.**
Ankandi do të zhvillohet më datë 12.03.2019 ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: givnth@hotmail.com. Publikimi i njoftimit te ankandit te filloje me date 08.03.2019 deri me date 12.03.2019.



Agjencitë ndërkombëtare të lajmeve i bëjnë jehonë protestës së opozitës

Mediat ndërkombëtare: Dhunë në protestën e opozitës në Tiranë

"Mitingu i opozitës, kundër korrupsionit qeveritar"

BALLA: OPOZITA TË HEQË DORË NGA DHUNA

"Besoj se opozita e ka marrë mesazhin, ajo duhet të heqë dorë nga këta skenarë të dhunshëm. Arsyeja pse LSI është në protestë dhe në dhunim të institucioneve është diçka e paralajmëruar. Rruga e drejtësisë së re nuk ndalet. Sot LSI dhe PD e kanë marrë mesazhin e qytetarëve", - u shpreh Balla.



Meta takon Merkelin: Mësimet e nxjerra nga shkuara, aktuale edhe sot

I gjendur në Gjermani ku po merr pjesë në Konferencën e Sigurisë në Mynih, Presidenti i Republikës, Ilir Meta ka ndjekur me shqetësim edhe zhvillimet gjatë ditës së djeshme në Tiranë. Ai u bëri thirrje palëve për vetëpërmbytje dhe respektim të institucioneve. "Duke ndjekur me vëmendje të veçantë protestën e opozitës, bëj thirrje për vetëpërmbytje nga të gjithë për evitimin e konfrontimeve dhe dhunës. Qytetarët duhet të protestojnë të lirë dhe duhet të respektohen institucionet", - shprehej presidenti në mesazhin e vet. Ndërkohë që gjatë punimeve të Konferencës së Sigurisë, ai takoi edhe kancelaren, Angela Merkel, ndërsa në një postim në rrjetet sociale, z.Meta vlerësoi mesazhet e përcjellura prej saj çështjeve të sigurisë. "Mesazhe të forta dhe të qarta të Kancelares Angela Merkel sot në Konferencën e Sigurisë në Mynih. Mësimet e nxjerra që nga koha e pas Luftës II Botërore mbeten po aq aktuale sot: uniteti evropian dhe partneriteti Trans-Atlantik, në themel të sigurisë dhe lirisë që gëzojmë sot. Marrëveshja e Prespës, një nga arritjet më të rëndësishme në fushën e sigurisë gjatë kësaj kohe", shkroi Meta.

Protesta e organizuar nga opozita para Kryeministritë ka gjetur një jehonë të gjerë edhe në mediat e njohura ndërkombëtare dhe ato të vendeve fqinje, që kanë një interes më të madh për zhvillimet në Shqipëri. Agjencitë ndërkombëtare të lajmeve e kanë përshkruar me nota realiste atë që ndodhi në 5 orë në bulevardin kryesor të Tiranës, ndërsa u janë referuar deklaratave të liderit të opozitës se policia i lejoi vetë protestuesit që të mësynin godinën e Kryeministritë. "Euronews" bëri një pasqyrim në kohë reale të ngjarjeve, duke evidentuar sulmin ndaj selisë së Këshillit të Ministrave. "Protestuesit nisën të shkallmojnë dyert e zyrës së Kryeministrit të Shqipërisë në Tiranë. Kjo po ndodh gjatë protestës së opozitës kundër korrupsionit qeveritar", - shkruan "Euronews", që e transmetoi të gjithë tubimin 'online'. Ndërkohë që media amerikane "Washington Post" në versionin 'online' u ka kushtuar një artikull të gjatë ngjarjeve në Tiranë, ndërsa thekson faktin se mijëra qytetarë protestuan kundër qeverisë, të cilën e konsiderojnë të korruptuar. "Washington Post" shkroi se mijëra mbështetës të opozitës në Shqipëri janë përplasur me policinë në një protestë anti-qeveritare, ndërsa kanë garë kordonin e policisë duke tentuar të futen edhe në Kryeministri. Ndërsa "Reuters" shkruan se, "protestuesit, pasi hodhën bomba molotov, u përpoqën të theynin xhamat e Kryeministritë, duke i goditur me mjete të forta". E njëjta agjenci raporton se oficerët të policisë u bënë thirrje protestuesve për t'u qetësuar. Media tjetër italiane "La Republica", gjithashtu e ka vënë theksin



"LA REPUBLICA"

"Dhunë në protestën e opozitës në Tiranë. Mijëra persona kanë dalë në sheshin e kryeqytetit shqiptar, duke protestuar kundër qeverisë së Edi Ramës, duke kërkuar dorëheqjen e kryeministrit. Protestuesit, të organizuar nga Partia Demokratike kanë thyer kordonin e policisë, duke kërkuar të futen në Kryeministri me dhunë", - shkroi "La Republica".

tek dhuna e treguar në protestë dhe përpjekjet për t'u futur në Kryeministri. "Dhunë në protestën e opozitës në Tiranë. Mijëra persona kanë dalë në sheshin e kryeqytetit, duke protestuar kundër qeverisë së Edi Ramës, duke kërkuar dorëheqjen e kryeministrit. Protestuesit, të organizuar nga Partia Demokratike kanë thyer kordonin e policisë, duke kërkuar të futen në Kryeministri me dhunë", - shkroi "La Republica". Ndërkohë që media kryesore greke "Ta Nea" ka bërë një raportim të ftohtë të ngjarjeve që shoqëruan protestën e opozitës, teksa duke i referuar fjalimeve të kryedemokratit Basha, thekson se policia i la vetë protestuesit që t'i afroreshin godinës për të

sur demonstruesit e zemëruar. Në imazhet e transmetuara në mediat ndërkombëtare dhe shqiptare shohim shumë protestues të gjakosur, që shtrihen në tokë si dhe dy policisë të plagosur që u mjekuan në spitalin e kryeqytetit shqiptar. Herët në mëngjes, protestuesit thyen rrjetën e policisë dhe arritën të hyjnë në oborrin e rezidencës. Një grup prej rreth 100 njerëz filluan të lëshojnë gurë dhe tym kundër policisë duke thirrur "Rama, ik!". Gurët thyen dritaret e ndërtesës, ndërsa një grup protestuesish u përpoqën të sulmonin Pallatin, por u zmbarsën nga oficerët e policisë", - shkruan "Ta Nea" në kronikën e vet për ngjarjen.

"EURONEWS"

"Protestuesit nisën të shkallmojnë dyert e zyrës së Kryeministrit të Shqipërisë në Tiranë. Kjo po ndodh gjatë protestës së opozitës kundër korrupsionit qeveritar", - shkruan "Euronews".

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 06.03.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i lirisë për shlyerjen e pasurisë së pallogjishme. Apartamenti me sipërfaqe totale 45.2 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 561/28+1-25, Vol.13, Fq.41, Zk.3976 në pronësi të Hipotekuesit shoq. Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoçëz, Tiranë me vlerë fillëstare në ankand 10,147.2 (Dhjetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë dy) EUR dhe Apartamenti me sipërfaqe totale 63.3 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 56/28+1-26, Vol.13, Fq.42, Zk.3976 në pronësi të Hipotekuesit shoq. Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoçëz, Tiranë me vlerë fillëstare në ankand 14,179.2 (Katërmëbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë dy) EUR. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email: enuar.merko@gmail.com

Zgjidhet ngërçi për mbivendosjet, legalizohet ai që deklaron i pari

Ligji i ri për pronat prek edhe ndërtimet pa leje, ja kush kualifikohet

Përplasjet mes pronarëve, ankimimi në Apel

Projektligji për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësive prek edhe ligjin për legalizimet. Personat që kanë ndërtuar pa leje, por janë në konflikt për të njëjtin ndërtim do të mund të marrin zgjidhje pas miratimit të draftit që është për diskutim në parlament. Në projektligj sanksionohet se do të marrë lejen e legalizimit për objektin personi që ka deklaruar i pari, ndërsa palët e tjera mund t'i drejtohen gjykatës. Në projektligj, në kreun III të tij

parashikohen procedurat për ligjësimin e ndërtimeve dhe trullatit pa titull pronësie. "Në të parashikohen kriteret e legalizimit të ndërtimeve pa leje, të përfshira në këtë proces sipas legjislacionit në fuqi (evidencimi, kriteret, dokumentacioni i nevojshëm, afatet, kalimi i pronësive). Dispozitat që i përkasin trajtimit të ndërtimeve pa leje në proces legalizimi parashikojnë gjithashtu edhe rastet kur subjekti posedon më shumë se një ndërtim pa leje, komp-



simin për pronarët joposuedes, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për të drejtat mbi ndërtimin që legalizohet (nëse gjatë procedurave të legalizimit konstatohet se për

të njëjtin ndërtim pa leje ka aplikime nga dy ose më shumë subjekte, procedurat e legalizimit vijojnë në favor të subjektit që ka aplikuar i pari në kohë; mosmarrëveshjet mes subjekteve aplikuese dhe pretendimet e të tretëve, për të drejta mbi ndërtimin pa leje, apo për raportet e pronësive mbi këtë ndërtim, zgjidhen nga gjykata", - thuhet në relacionin e projektligjit.

NDËRTIMET QË PËRJASHTOEN

Kreu III ka një dispozitë të dedikuar për trajtimin e banesave që përjashtohen nga legalizimi (ndërtimet pa leje (banesat) që përjashtohen nga legalizimi, sipas nenit 15, ku në pikën 1 të tij thuhet se, "ASHK-ja (Agjencia Shtetërore e Kadastrës kryen procedurat e kualifikimit për legalizim të ndërtimeve pa leje, duke u bazuar në kriteret e mosnimit të: veprave kryesore të infrastrukturës publike, akteve rrugore kombëtare, territorit apo funksionalitetit të ndërtesave publike, integritetit të monumenteve të kulturës, territoreve të destinuara për investime strategjike, sipas ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", vijës bregdetare. Në kuptim të interesit publik në zhvillimin e turizmit". Në pikën dy është përcaktuar se ndërtimet pa leje, që cenojnë kriteret e

mësipërme përjashtohen nga legalizimi. "Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, kriteret e mësipërme sjellin përjashtimin nga legalizimi vetëm për sipërfaqet në tejkallim të lejes së ndërtimit, kur ato janë të ndashme nga ndërtimi kryesor (ndërtimi me leje). Në rastin kur këto sipërfaqe nuk janë të ndashme, objektet me shkelje të lejes së ndërtimit legalizohen në tërësi. Procedurat, dokumentacioni dhe kushtet e kualifikimit për legalizim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave", - thuhet në projektligj.

SIPËRFAQET

Lidhur me objektet pa titull pronësie dhe oborret në përdorim, projektligji përmban dispozitat që përcaktojnë procedurat e pajisjes me titull dhe të regjistrimit të tyre. Në këtë kuadër, ASHK-ja miraton dokumentin e pronësive për sipërfaqen e trullit funksional, që kalon në pronësi pa pagesë (deri në 300 m²). Gjithashtu, parashikohet një rregullim i veçantë për rastin kur trulli funksional i objektit pa titull pronësie, apo oborri në përdorim rezultojnë në pronësi të të tretëve, duke u referuar të rregullat e parashikuara në nenin 21, të këtij ligji. Në këto raste poseduesi duhet të paguajë çmimin e trullit, sipas hartës së vlerës së pronësive të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

PROJEKTIGJI I RI PËR PËRFUNDIMIN E PROCESEVE KALIMTARE TË PRONËSISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 14

Evidentimi i ndërtimeve pa leje

1. Evidentimi i ndërtimeve pa leje kryhet nga ASHK-ja, nëpërmjet përditësimit të gjendjes ndërtimore në terren, duke konstatuar edhe funksionin e përdorimit.
2. Për ndërtimet pa leje, që futen në kategorinë e objekteve me shkelje të lejes së ndërtimit, krahas evidentimit të gjendjes ndërtimore në terren, ASHK-ja administron edhe dokumentacionin e lejes së ndërtimit.
3. Dokumentacioni dhe rregullat e hollësishme të evidentimit në terren përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Kriteret për legalizim

1. ASHK-ja (Agjencia Shtetërore e Kadastrës (kryen procedurat e kualifikimit për legalizim të ndërtimeve pa leje, duke u bazuar në kriteret e mosnimit të: veprave kryesore të infrastrukturës publike, akteve rrugore kombëtare, territorit apo funksionalitetit të ndërtesave publike, integritetit të monumenteve të kulturës, territoreve të destinuara për investime strategjike, sipas ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", vijës bregdetare, në kuptim të interesit publik në zhvillimin e turizmit.
2. Ndërtimet pa leje që cenojnë kriteret e mësipërme, përjashtohen nga legalizimi.
3. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, kriteret e mësipërme sjellin përjashtimin nga legalizimi vetëm për sipërfaqet në tejkallim të lejes së ndërtimit, kur ato janë të ndashme nga ndërtimi kryesor (ndërtimi me leje). Në rastin kur këto sipërfaqe nuk janë të ndashme, objektet me shkelje të lejes së ndërtimit legalizohen në tërësi.
4. Procedurat, dokumentacioni dhe kushtet e kualifikimit për legalizim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16,

përgjegjësia në raste fatkeqësish

Shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblimin në rast fatkeqësish, si pasojë e faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e ndërtimit pa leje. Poseduesi i ndërtimit të legalizuar mban përgjegjësinë për çdo pasojë që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës.

Neni 17, dokumentacioni për legalizim

1. Dokumentacioni për legalizimin e ndërtimit pa leje përfshin: a) Genplanin e ndërtimit. b) Planimetrinë e çdo kati të ndërtimit dhe sipërfaqet në m². c) Akt ekspertizat nga një ekspert ose ent i licencuar për qëndrueshmëri konstruktive të objektit, për ndërtimet me lartësi mbi 4 kate. 2. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, në dokumentacionin e legalizimit, përveç sa parashikohen në pikën 1, të këtij neni, ASHK-ja administron edhe aktmarrëveshjen me pronarin e trullit për ndërtimin kryesor, nëse është ndërtuar

në territor privat, si dhe aktmarrëveshjen për shtesën, nëse ka të tillë. Në mungesë të aktmarrëveshjes për shtesën, të drejtat dhe detyrimet e palëve për ndërtimin kryesor njësohen me të drejtat dhe detyrimet e palëve në shtesën pa leje.

Neni 18

Legalizimi i ndërtimit

1. ASHK-ja brenda 60 ditëve nga përfundimi i procedurave të kualifikimit legalizon ndërtimin, duke respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për regjimit pasurorë martesorë.
2. Poseduesi i ndërtimit pa leje ka të drejtë të kërkojë përfundimin e procedurave administrative brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, kundrejt pagesës së një tarife shërbimi shtesë. 3. Modeli dhe rregullat për nxjerrjen e aktit të legalizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Parcela ndërtimore dhe kalimi i pronësive

1. ASHK-ja përcakton sipërfaqen dhe konfigurimin e parcelës ndërtimore për subjektin që disponon ndërtimin e legalizuar.
2. Kur poseduesi i ndërtimit nuk është pronar i parcelës ndërtimore, akti i legalizimit të ndërtimit nga ASHK-ja shërben edhe si akt i kalimit të pronësive mbi trullin e parcelës.
3. Përcaktimi i sipërfaqes së parcelës ndërtimore, që kalohet në pronësi, kryhet sipas rregullave të mëposhtme: a) Në rastin e ndërtimeve pa leje, me funksion banimi, si tregull, sipërfaqja e parcelës ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësive, mund të jetë deri në masën e trefshit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast, jo më e madhe se 500 m². b) Për ndërtimet pa leje, me funksion social-ekonomik, zbatohet vetëm kriteri i trefshit të sipërfaqes së bazës së ndërtimit. c) Kur për shkak të përmasave ose planvendosjes së parcelës ndërtimore krijohen sipërfaqe të lira, që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i kalohen në pronësi poseduesit të ndërtimit pa leje, sipas çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës së pronësive, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Kalimi i së drejtës së pronësive për këto sipërfaqe kryhet vetëm nëse poseduesi i ndërtimit pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Në çdo rast, për ndërtimet me funksion banimi, sipërfaqja deri në 500m² paguhet me çmim favorizues.

4. Për parcelat ndërtimore, të cilat gjenden në pasuri në përgjegjësi administrimi të institucioneve shtetërore, me kalimin e pronësive, sipas këtij neni, shuhet vetvetiu edhe përgjegjësia e administrimit. Për këto sipërfaqe, ASHK-ja njofton institucionin përkatës.

5. Për parcelat ndërtimore që shtrihen në pasuri të transferuara të njëstë e vetëqeverisjes vendore, sipas ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njëstë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, ky transfer-

im konsiderohet i revokuar/shfuqizuar vetvetiu me miratimin e kalimit të pronësive sipas këtij neni. ASHK-ja njofton njësinë e vetëqeverisjes vendore për revokimin dhe kjo e fundit ka të drejtë t'i kërkojë Këshillit të Ministrave zëvendësimin e pasurive të zëna me ndërtime pa leje me pasuri të tjera shtetërore, të lira.

6. Për parcelat ndërtimore që shtrihen në trull privat, në pronësi të të tretëve, kalimi i së drejtës së pronësive realizohet në çastin e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin e pronarëve joposuedes. Deri në atë çast, ndërtimi regjistrohet pa marrëdhënie me trullin.
7. Të drejtat reale të të tretëve mbi trullin nuk pengojnë kalimin e pronësive së parcelës ndërtimore.
8. Çmimi i shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje, me funksion banimi dhe të pëzier (social-ekonomik dhe banimi) është çmim favorizues, ndërsa për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik, është ai i përcaktuar në hartën e vlerës së pronësive për llojin e pasurisë "trull".
9. Paga e vlerës së parcelës ndërtimore bëhet në lekë, në vlerë të plotë monetare dhe me bono privatizimi. Bonot e privatizimit, të përfuturara nga ish-të përdjekurit politikë dhe nga subjektet e tjera gjatë procesit të privatizimit të pronës shtetërore kanë të njëjtin trajtim me bonot e tjera të privatizimit.
10. Deri në shlyerjen e vlerës së plotë të detyrimit financiar për parcelën ndërtimore, mbi pasurinë e legalizuar rëndon hipoteka ligjore.
11. Rregullat e hollësishme për kalimin e së drejtës së pronësive, pagesën, çmimin favorizues, kategoritë e subjekteve që përfitojnë dalje si dhe përqindjet e përdorimit të bonove të privatizimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Rastet kur subjekti posedon më shumë se një ndërtim pa leje

1. Në rast se një subjekt posedon më shumë se një ndërtim pa leje, ai ka të drejtë të zgjedhë me akt notarial se për cilin do të përfitojë pronësinë e parcelës ndërtimore sipas çmimit favorizues të legalizimit. Për ndërtimet e tjera zbatohet çmimi i përcaktuar në hartën e vlerës së pronësive, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe tarifa e shërbimit, pavarësisht nga kategorizimi i funksionit të objekteve apo sipërfaqja e parcelës ndërtimore.
2. Kur subjekti nuk paraqet deklaratën notariale, sipas pikës 1 të këtij neni, ASHK-ja e trajton me çmim favorizues ndërtimin me sipërfaqen më të vogël të parcelës ndërtimore.
3. Kur subjekti që posedon më shumë se një ndërtim transferon me akt notarial të drejtat mbi njërin apo më shumë ndërtime të të tretët, nuk aplikohet çmim favorizues për asnjë prej ndërtimeve.

Kësti i tretë, fëmijët e ish-dënuarve duhet të plotësojnë dokumentet brenda 10 ditëve

Ish-të përndjekurit, 1000 trashëgimtarët që marrin paratë
Ministria e Financave publikon të dhënat për dosjet

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentet që u mungojnë në dosje për të mos humbur të drejtën për të marrë paratë. Fëmijët e ish-të dënuarve politikë kanë edhe 10 ditë kohë për plotësimin e dokumentacionit. Burime zyrtare nga Ministria e Financave bëjnë të ditur se janë mbi 1000 trashëgimtarë të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të cilët duhet të plotësojnë dosjet për të filluar pagesat e kështit të tretë. Sipas të njëjtave burime, mësohet se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogar-



ia nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet mbrypas në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemë-

ri qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe qdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon

edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuarit është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave.

ISH-TE PËRNDJEKURIT QË MARRIN PARATË

Table with 40 columns and many rows, listing names of individuals under the heading 'ISH-TE PËRNDJEKURIT QË MARRIN PARATË'. The table is organized in a grid format with multiple columns.

ANGJELINA	NIKOLLI	CERKEZI	DHIMOSTEN	ALEKS	BALLA	BEHJJE	XHELAL	MEHALLA
ROZA	NIKOLLI	ANAGNOSTI	SADJJE	MEHMET	PETRELA	FADIL	XHELAL	KUMRIJA
RENATO	NIKOLLI	XHXHAJ	ARBEN	MALIQ	PETRELA	FIQIRETE	XHELAL	BAJ
LAVER	ISMAIL	KOLAVERI	SHEFKI	MALIQ	PETRELA	HATI	XHELAL	LICI
SHKENDI	ISMAIL	HAZIJ	ABAZ	SEFEDIN	SKENDERI	ISA	XHELAL	KUMRIJA
DASHURI	ISMAIL	EMINI	ASTRIT	SEFEDIN	SKENDERI	MUSTAFA	XHELAL	KUMRIJA
BUKURJJE	ISMAIL	JAHJOLLI	IVZI	SEFEDIN	SKENDERI	MYRTEZA	XHELAL	KUMRIJA
HAMIDE	OSMAN	MAHMUDAJ	FLORA	SEFEDIN	MUCA	XHELAL	XHELAL	KUMRIJA
ISMAIL	OSMAN	FAZLIIU	FIQIRETE	SEFEDIN	SKENDERI	VEIS	XHELAL	KUMRIJA
DEMIR	OSMAN	FAZLIIU	PASHKE	MARTIN	DOCI	ISMAIL	XHELAL	KUMRIJA
BUJAR	OSMAN	FAZLIIU	MARJJE	MARTIN	GJONAJ			
MARK	PAL	MHILLAJ	PASHK	MARTIN	DOCI	BUJAR	DERVISH	KASHARI
DRANE	PAL	CUPI	MARTE	MARTIN	ALCANI	DERVISH		KASHARI
ERVVEHJ	SABRI	MOLLA	GJYSTE	MARTIN	PILAJ	KADRJJE		TUSHE
BURBUQE	SABRI	MHILL	MHILL	MARTIN	DOCI	SHEGJERE		KOKOSHI
PASHK	BUSHI	KASTRIOT	GJELINA	MARTIN	DOCI	YLLI		KASHARI
ENGJELL	PAL	BUSHI	BESHNIK	MARTIN	JAKU	QANI		KASHARI
DILE	PAL	BUSHI	GJENOVEFA	ALI	DERVISHI		ELMAZ	
LAZDER	PAL	BUSHI	MARTE	ALI	KRAJA	SKENDER	CAUSH	BALLIU
GJERGJ	LAZER	BRUNGA	BRUNGA	PASHK	PIROLI		ISMAIL	
GJET	LAZER	BRUNGA	HANEM	RASHIP	BABAMETO	HAMIT	IDRIZ	DODA
LLESH	LAZER	BRUNGA	MENTOR	HAJRO	BABAMETO	KUTJIM	IDRIZ	DODA
NDUE	LAZER	BRUNGA	MENTOR	HABANI	BABAMETO	SKENDER	IDRIZ	DODA
PRENDA	LAZER	BRUNGA	FATMIR	HABANI	BABAMETO	VERE	IDRIZ	DISHI
NADIRE	NJAZI	BLLOSHMI	MUHALEM	BESIMX	HYDOLLARI		QERIM	
PELLUMB	NJAZI	MUCO	SHKELQIM	BESIMX	HYDOLLARI	ENGJELLUSHE	AGIF	ASQERI
RAFO	NJAZI	MUCO	SHPRESA	BESIM	KODRA	ARBEN	AGIF	SELMIM
HADJJE	MUHAMET	KARAPITI	VEIP	BESIM	XHYDOLLARI		ILIAS	
ZAMIRA	ENVER	CABOKU	HASAN	QERAM	GURI	ALI	DAJLAN	
SHYQYRI	ENVER	KARAPITI	AHMET	SABRI	GJOGJEGJA	BEKTASH	DAJLAN	SHUKARAZI
		FEMJJE I MITUR	QAZIM	SABRI	GJOGJEGJA	ELIMA	DAJLAN	SHUKARAZI
			ZABIT	SABRI	GJOGJEGJA	NEDINE	DAJLAN	SHUKARAZI
			MIMOZA	SABRIALIA	GJOGJEGJA		KOLE	
			SANIE	AHMET	GJOGJEGJA		NDOC	KOLA
			NAZLIKO	ILMI	GJOGJEGJA		NDOC	KOLA
			AGRON	ILMI	GJOGJEGJA		PASHKE	KOLA
			ADRIATIK	RIZA			TONI	KOLA
			YLLI	RIZA			NDOC	KOLA
			PETRIT	RIZA			GJOK	
			TOTA	RIZA		FILE	LAZER	VATNIKAJ
			NDRECA	RIZA		PASHUK	LAZER	VATNIKAJ
			VJOLLCA	RAMADAN		SHAN	LAZER	VATNIKAJ
			MAKBULE	DEME			LAZER	VATNIKAJ
			KERCAKU	HAMZA			LAZER	VATNIKAJ
			ISMAIL	HAMZA		DEMIRAL	RAMIZ	CELA
			KALAJ	HAMZA		DYLBER	RAMIZ	CELA
			KOLA	HAMZA		KRISTINA	RAMIZ	DUKA
			LEKA	HAMZA			MARK	
			HOXHA	HAMZA		ALBERT	GJON	NDQJ
			TUSHA	FATBARDHAMUHAREM		VALENTIN	GJON	NDQJ
			ABERDAKU	MUHAREMS		VERA	GJON	NDQJ
			ABERDAKU	PETRO		VITTORE	GJON	NDQJ
			IRENA	VASIL		VALENTIN	GJON	NDQJ
			ABERDAKU	KETTI			EMIN	
			SHLLAKU	VASIL		FEJZI		
			UJKAJ	ADRIAN		VERGJINUSHSHEFKILAME		
			UJKAJ	KOZARA		RAMADAN	SHEFKI	HYZEIR
			UJKAJ	PRANVERA			ABAZ	
			VARESI	NIMETE		VASFIE	DALIP	KULEMANI
			VARESI	ABDURAMAN		DESTAN	ABAZ	KULEMANI
			TASI	KUDRET		FEMI	ABAZ	KULEMANI
			ILIRIAN	KUDRET		PELLUMB	ABAZ	KULEMANI
			SERVETE	KUDRET		RYRACO	ABAZ	KOSIQI
			KUDRET	KUDRET		MUHARREM	ABAZ	KULEMANI
			VESEL	KUDRET		RRUZHDI	ABAZ	ABAZI
			SADETE	ARIF			Selim	
			GJINAJI	TAHIR		Hasan	Jakup	Shalesi
			LUMBE	TAHIR			Jakup	Naziraj
			TEUTA	TAHIR			Jakup	Klosi
			GAZMIR	AZIZ		Turbullira	Jakup	Doc
			SHERIF	AZIZ		Zenele	Jakup	Shalesi
			XHEVDET	AZIZ		Fatime	Jakup	Sallilari
			VASHA	AZIZ		Hafize / Hafeza / Afesa	Jakup	Shalesi
			QYTZEZA	AZIZ		Lumturi	Jakup	Metaj
			KOKA	AZIZ			OSMAN	
			KOKA	AZIZ		NADIRE	RAMAZA	SELMIM
			DODA	AZIZ		FIQIRETE	XHAVIT	DUMI
			CAUSHI	AZIZ		MULETE	XHAVIT	CANAJ
			CAUSHI	AZIZ		DILAVER	XHAVIT	SELMIM
			CAUSHI	AZIZ		RAMAZAN	XHAVIT	SELMIM
			EGRA	ABAZ		SEMIHA	XHAVIT	MYRTAJ
			CAUSHI	SABRI			NEVRUZ	
			CAUSHI	SABRI		ZINETE	DEMIR	DESNIKU
			CAUSHI	SABRI		VALTER	XHEVAT	SEJJARAS
			CAUSHI	SABRI		SUZANA	XHEVAT	SEJJARAS
			CAUSHI	SABRI			DODE	
			CAUSHI	SABRI			GANI	
			CAUSHI	SABRI		DYRAZLIJE	RUSTEM	KULLA
			CAUSHI	SABRI		ALKETA	REBANI	MYSLI
			CAUSHI	SABRI		ZHULJETA	REBANI	SPAHO
			CAUSHI	SABRI			MUHARRREM	
			CAUSHI	SABRI		BUKURJJE	SHYQYRI	HOXHALLI
			CAUSHI	SABRI		DRTA	SHYQYRI	MYRTE
			CAUSHI	SABRI		FESTIM	SHYQYRI	BEGOLLI
			CAUSHI	SABRI		IFTADE	SHYQYRI	MENELLI
			CAUSHI	SABRI		MANUSHAQ	SHYQYRI	ADJINLLI
			CAUSHI	SABRI		MERJEME	SHYQYRI	BRISKU
			CAUSHI	SABRI		MYZEJEN	SHYQYRI	MANELLI
			CAUSHI	SABRI			HYSEN	
			CAUSHI	SABRI		AGIM	ALI	ZEQO
			CAUSHI	SABRI		DRINI	ALI	ZEQO
			CAUSHI	SABRI		LUAN	ALI	ZEQO
			CAUSHI	SABRI		FATMIR	ALI	ZEQO
			CAUSHI	SABRI		XHEVDET	ALI	ZEQO
			CAUSHI	SABRI			MARK	
			CAUSHI	SABRI		DAVE	PJETER	MARKU
			CAUSHI	SABRI		FLORINTE	PJETER	MARKU
			CAUSHI	SABRI		MARIE	PJETER	LUGAJ
			CAUSHI	SABRI		NDUE	PJETER	BIBA
			CAUSHI	SABRI		RRAPO	HYSEN	HAMITAJ
			CAUSHI	SABRI		XHEZMIE	HYSEN	HADJARI
			CAUSHI	SABRI		DESTIMONEHYSEN	ISARA	
			CAUSHI	SABRI			FERIK	
			CAUSHI	SABRI			SULEJMAN	
			CAUSHI	SABRI		KIMETE	SAIT	TAFILAJ
			CAUSHI	SABRI		ADMIR	BAHRI	TAFILAJ
			CAUSHI	SABRI		LUAN	BAHRI	TAFILAJ
			CAUSHI	SABRI		GENC	BAHRI	TAFILAJ
			CAUSHI	SABRI		DHURATE	BAHRI	TAFILAJ
			CAUSHI	SABRI			HYSEN	
			CAUSHI	SABRI		AGUR	HYSEN	VELESHMI
			CAUSHI	SABRI		ARJAN	HYSEN	VELESHMI
			CAUSHI	SABRI		ZYLIFTAR	HYSEN	VELESHMI
			CAUSHI	SABRI			FEJZI	
			CAUSHI	SABRI		AVDULLA	NURI	MECOLLARI
			CAUSHI	SABRI		DUDI	NURI	XHEMOLLARI
			CAUSHI	SABRI		FAHRIE	NURI	VELOLLARI
			CAUSHI	SABRI		HATIXHE	NURI	POTKA
			CAUSHI	SABRI		OLIMBI	NURI	METKO
			CAUSHI	SABRI			LUMAN	

ISH-USHTARI I UÇK

RAMË LAHAJ

Tenori i njohur, kundër prekjes së kufijve të Kosovës

Fatmira Nikolli


Me një zë rrëqethës që prej vitësh ka njohur sukses në skenat e operave më të mëdha botërore, Ramë Lahaj, interpreton këngën e Vaçe Zelës "Rrjedh në këngë e ligjërime". Shqipëria zëvendësohet me Kosovën në tekst dhe imazhet shoqëruese janë të Ushtrisë së Kosovës, që ecin nëpër borë dhe vënë flamurin e Kosovës në majë të lartë mali. Vetë Lahaj shfaqet duke lënë një tufë lule mbi varrin e Adem Jasharit, heroit të rënë në luftën e Kosovës.

Videoja dhe kënga janë realizuar me rastin e 11-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, por tenori i njohur ka dhënë edhe një mesazh dhe kur e ka publikuar atë.

"Të dashur bashkatdhetarë. Ky është video-projekti im i parë që si ambasador i kulturës në mbarë botën ia kushtoj Kosovës. Në këto kohëra të vështira me temat rreth kufijve dhe shumë të ri që na ikin çdo ditë nga vendi, do të doja që ky të ishte mesazh shprese. Përndryshe me FSK-në ishim dhe e ngritëm flamurin andaj të gjithë njëzëri të themi 'Mos na e prekni kufirin'. Videon e plotë mund ta shihni nesër në 11-vjetorin e krijimit të shtetit e 20-vjetorin e çlirimit. Të duam Kosovë!"

Ramë Lahaj është cilësuar si ylli i ri i Operës nga Plácido Domingo. Por ai ka pasur një udhëtim të gjatë, nga ushtar i UÇK-së, në tenor me famë botërore. 35 vjeç, por në majën e suksesit, tenori që ka pushtuar skenat e Europës vjen nga një e kaluar e trishtë. Bëhet fjalë për tenorin Ramë Lahaj. Vetë ai, përmes një postimi në "Facebook" u bënte thirrje të rinjve e të reja që asnjëherë të mos i braktisin ëndrrat.

Duke u nisur nga shembulli i tij ku para 20 vitësh ishte ushtar i UÇK-së dhe sot tenor i famshëm, Lahaj kërkon që të gjithë të bëhen luftëtarë të fuqishëm



Ramë Lahaj me uniformën e UÇK-së

Videoja dhe mesazhi: E ngritëm flamurin, andaj të gjithë njëzëri të themi "Mos na e prekni kufirin"

për të fituar betejat. "20 vjet ndryshim. Ushtar në luftë, ushtar në paqe. Bonu luftëtar i fuqishëm i jetës tande dhe fito të gjitha bete-

jat që ia ke vënë vetës për synim. Projekto dhe realizo strategjinë për luftën tande. Mos u bon qyqar e me kalu kohën tuj u anku-



se jeta asht e vështirë dhe hiç gjë s'shkon qysh duhet! Bonu ushtar i denjë dhe mos lë front të ëndrrave të tua pa e fitue. Kësaj herë t'fala nga Opera e Barcelonës, një prej fronteve të mia që sot më bon krenar që e fitova me nder", shkruante ai.

Në finalen për çmimin prestigjioz "Operalia", tenori i mirënjohur kosovar, Ramë Lahaj, ka rrembyer vendin e tretë. Tenori kosovar, Ramë Lahaj, ka qenë fitues i dy çmimeve të para nga tri kategoritë e festivalit "Ritorna Vincitor", në Napoli të Italisë, në edicio-

nin XVI të tij. Lahaj është fitues edhe i dy çmimeve tjera me karakter ndërkomëtar, "Marie Kraja" dhe "Riva del Gardes". Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" vite më parë ai shprehej se, "Saimir Pirgu është këngëtar i preferuar, tenori i preferuar dhe është idhulli im. Jam i lumtur që ne sot kemi këngëtarë si Saimir Pirgu dhe Ermone-la Jaho. Para pak kohësh kam pasur një bashkëpunim së fundmi me Ermone-len dhe mund të them se në opinionin tim, ajo është një divë shqiptare". Atë kohë, ai pat rrëfyer se në Tiranë e ka kaluar shumë mirë, po ka pasur edhe vështirësi. "Kam ardhur në Akademinë e Arteve pa mbaruar një shkollë muzike dhe më është dashur t'i kapërdij programin për gjashtë muaj dhe më tej kam ardhur këtu ku jam". Ardhur prej Istogut drejt kryeqytetit të shqiptarëve, Tiranës, përveçshkollimit, këtu do të zinte fill edhe sukcesi i tij. Konkursi ndërkomëtar "Marie Kraja" i dha atij hovin e parë drejt suksesit, e më tej do të vinin me radhë skenat e konkurset italiane e gjermane, prej ku do të dilte duarplot.

DORIAN KOÇI:

DEMETRIO LECCA, DHIMITËR LEKA I HIMARËS

Një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të elitës arbëreshe është padyshim Jeronim De Rada, që ndryshe nga paraardhësit e vet jo vetëm pati meritën që hapi siparin e Romantizmit në letërsinë shqipe me veprën e tij "Këngët e Milosaos" 1836, por për herë të parë e integroi letërsinë e një komuniteti të vogël në rrjedhat europiane të kohës. Studiuosi Dorian Koçi, thotë se në botimin e parë të librit De Rada vë si epigrafi vargjet e poetit grek Pindari: "Muzat, më ndihmuan mua - që

me një varg të ri të shndritshëm - ta përshtat ritmin dorik". Epigrafi jepet në greqishten klasike, shënon Koçi duke shtuar se libri i kushtohet Demetrio Leça dhe ka këtë shënim: "Shkëlqesisë së Tij, Gjeneral Brigadier, Komendator, Zotit Dhimitër Leka, këto këngë, që të jenë dëshmi e lidhjeve shpirtërore me zakonet e lashta ndër njerëzit e shpërndarë të Epirit (Shqipërisë)". Po kush ishte Demetrio Leça/Dhimitër Leka? Ai vinte nga një familje me origjinë shqiptare nga Dhërmiu i Himarës, të vendosur në Napoli në fund të shekullit të XVIII. Dhimitër



Leka lindi në 24 prill 1779 në Dhërmi dhe vdiq në Napoli, më 21 prill 1862. Ai bëri një karrierë të shkëlqyer ushtarake, duke arritur gradën e gjeneral brigadierit në oborrin e Mbretit të Napolit. Dhimitër Leka u varros në Kishën Ortodokse të Napolit dhe aty gjendet varri sarkofag i tij së bashku me bustin e gdhendur në basoreliev, vepra të porositura nga i biri i tij Achille Leka. Mbishkrimi është në italisht: "Dhimitër Lekës, epirot, tenent gjeneral i ushtrisë napolitane, i urdhrat të Shën Gjergjit të bashkimit dhe Shën Salvadore të Greqisë Shën Anës së Rusisë dhe Shën

Mikelit të Bavarisë Kalorës i Kryqit të Lartë, lindur në Drimadhes më 24 prill 1779 vdekur në Napoli më 21 prill 1862".

Atit trim dhe të ndershëm, Akil Leka i ngre në kujtim. Në gurrën popullore shqiptare ai përkujtohet nga disa vargje që i ka botuar i ndjeri Llabro Ruci në librin e vet "Zera e Akro-keaurëneve".

Ç'u hap mandati në drekë,

Hajmedet o Dhimitër Lekë,

Hajmedet se ç'të ka gjetë,

gjëndërali i Bregdetë, kapetan i mirë me fletë, në stere edhe ndë detë.

Krimet e Rënda, detyrim paraqitje për kreun e 'Kufirit' dhe një zyrtar tjetër

Klodiana Lala

TIRANË

Lirimi i trafikantit Naser Gashi, në kërkim shefi i policisë së Kukësit

Skandali, në pranga efektivi Kujtim Spahia

Gjykata për Krime të Rënda urdhëroi arrestime në komisariat në Kukësit, pas lirim të kosovarit të shumëkërkuar për trafik droge, Naser Gashi. Gjykata caktoi masën e arrestit me burg në mungesë për Agim Bashën, shef i komisariatit në Kukësi, nën akuzën e korrupsionit e shpërdorimit të detyrës. Arrestimi i kryekomisarit të Kukësit nuk është mundur të kryhet, pasi Agim Basha nuk është gjetur nga forcat e policisë. Me po të njëjtat akuzat, gjykata ka lëshuar masën e arrestit me burg edhe për Kujtim Spahiu, vartës i Bashës në komisariat. Spahiu, me detyrë specialist i Policimit në Komunitet, pranë Komisarariatit të Policisë Kukësi ka përfunduar në pranga. Spahiu akuzohet për veprat penale "Korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë" dhe "Falsifikim të dokumenteve me pasoja të rënda". Ndërkohë, gjykata në fjalë ka vendosur masën "Detyrim paraqitje" ndaj Ferdinand Gjetës, i cili është drejtor në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit në Kukësi dhe Sh-

DENONCIMI

Hetimet ndaj zyrtarëve të policisë së Kukësit nisën pas denoncimit të bërë në Prokurorinë për Krime të Rënda nga zv.drejtori i Hetimit në këtë qark, Shkëlqim Pepkolaj, i cili prej disa ditësh është larguar jashtë vendit, duke kërkuar azil politik bashkë me familjen. Pepkolaj akuzonte zinxhirin komandues të Drejtorisë së Policisë Kukësi se kishte kryer veprime të rënda për sa i përket trajtimit të rastit të arrestimit të të dënuarit me 7.4 vite burgim, Naser Gashi.



Naser Gashi

këlzen Ibaçi, specialist në sallën e komandimit në Drejtorinë e Policisë në Kukësi për shpërdorim detyre. Hetimet

ndaj zyrtarëve të policisë së Kukësit nisën pas denoncimit të bërë nga zv.drejtori i Hetimit në këtë qark, Shkël-

qim Pepkolaj, i cili prej disa ditësh është larguar jashtë vendit, duke kërkuar azil politik bashkë me familjen. Nga hetimet rezultoi se mbremjen e 17 tetorit 2018, në pikën kufitare të Morinës paraqitet në dalje një person me identitetin Samir Bula. Ai udhëtonte me makinën e tij tip "Audi" me targa 05808 DH, ndërsa si pasagjer ishte Ron Nimani. Policia e ka përzgjedhur Samir Bulën për kontroll në vijë të dytë, pasi

kishte dyshime se përdorte dokumente të falsifikuara. Ai është transferuar në Drejtorinë e Policisë së Kukësit, ku i është nënshtruar identifikimit nëpërmjet shenjave të gishtërinjve, nga ku ka rezultuar se personi në fjalë nuk ishte Samir Bula, por Naser Gashi i datëlindjes 1960, nga Kosova, i cili rezultonte i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me 7 vite e 4 muaj burgim. Ai ishte

shpallur në kërkim me kartelë të kuqe, pasi i mbeteshin edhe 2454 ditë burg për të vuajtur. Policia e Kukësit ka bërë arrestimin e personit në fjalë, por më pas prokurorja Rita Gjati ka urdhëruar lirimin, për shkelje procedure. Në vendimin e firmosur prej saj thuhet se, "në rastin konkret nuk janë respektuar kërkesat e ligjit për arrestimin në flagrancë dhe në këto kushte duhet të bëhet lirimi i menjëhershëm i Naser Gashit".

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



MASAT E DHËNA NGA GJYKATA E KRIMEVE TË RËNDA PËR ZYRTARËT E POLICISË

I ARRESTUAR

Kujtim Spahia, me detyrë specialist i Policimit në Komunitet, pranë Komisarariatit të Policisë Kukësi, për veprën penale të "Korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë" dhe "Falsifikim të dokumenteve, me pasoja të rënda", parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, për të cilin Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg".

NË KËRKIM

Agim Basha, me detyrë shef i Komisarariatit të Policisë Kukësi, për veprën penale të "Korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë" parashikuar nga neni 139/ç i Kodit Penal, për të cilin Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg". Ai është shpallur në kërkim.


"DETYRIM PARAQITJE"

1. Ferdinand Gjeta, me detyrë drejtor në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, Kukësi, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilin Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka caktuar masën e sigurisë "Detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore".
2. Shkëlzen Ibaçi, me detyrë specialist në sallën e komandimit në DVKM, Kukësi, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilin Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka caktuar masën e sigurisë "Detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore".

E DIEL

17 Shkurt

2019



NGA NDREK GJINI

IMZOT KAÇORRI përballë mbretit të Austro-Hungarisë, FRANZ JOZEF I

Askush nuk mund ta mo hoje kontributin e vyer të Ismail Bej Vlorës në Shpalljen e Pavarësisë. Por janë te pakte ata që e dëne se pas aktit të Shpalljes së Pavarësisë ai qëndroj në Shqipëri gjithsejt 42 ditë. Duke mbajtur postin e Kryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm, detyra ia donte, Ismail Bej Vlorës, të udhëtonte neper bote. Pra për rrjedhojë i bie që (de facto) me drejtimin dhe punët e asaj qeverie të jete marre Imzot Nikolle Kaçorri. Se si kane rrjedhur punët me vone për Kaçorrin, kjo dihet. Por dihet pak apo aspak rreth jetës dhe veprimtarisë së tij.

Informacione të bollshme rreth jetës dhe veprimtarisë atdhetare të Imzot Nikolle Kaçorrit japin disa artikuj në Revistën "Leka", e cila dilte në Shkodër para periudhës se

komunizmit. Studimi me i plotë tani, besoj, është ai i Imzot Pren Koles me titull "Imzot Nikolle Kaçorri për meveshtesinë e Shqipërisë", i cili është botuar në revistën "Shpresa" të Prishtinës dhe "Zeri i Shen Nikollës" në Velezhe të Prizrenit.

Imzot Nikolle Kaçorri u lind në vitin 1862 në fshatin Kre i Bajra-

kut të Lures. Babai i tij ishte katolik, ndërsa nëna muslimane. Arqipeshkvi i Durrësit Imzot Ambrosio pas një vizite që bëri në Lure e mori me vete për ta përgatitur për meshtar.

Në vitin 1884 mbaroi studimet filozofiko-teologjike për meshtar dhe u shugurua po të njëjtin vit në Shkodër. Sherbeu në Delbnisht,

pastaj u emërua famullitar në Durrës. Papa i asaj kohe e nderoi me "Kryqin e arte", "Per Kishe dhe Pape". Po në këtë vit emerohet edhe Ipeshkvi. Në vitet 1905-1907 drejtoi kryengritjen kundër turqve në Kurbin.

Në vitin 1908 merr pjesë në Kongresin e Manastirit së bashku me At Gjergj Fishten e shumë atd-

hetare të tjere. Fale kontributit të tij dhe të disa klerikeve të tjere katolike në këtë kongres kemi sot një alfabet latin dhe jo turk apo cirilik. Imzot Nikolle Kaçorri mori pjesë në Kongresin e Elbasanit i cili synonte të korigjonte imazhin negativ të kongresit të Dibres (korrik 1909) të organizuar prej xhonturqve. Revistes "Leka" flet edhe për gjyqin dhe denimin me disa vjet burg dhe gjobe në të holla të Nikolle Kaçorit, nga regjimi xhonturk i asaj kohe, lajme të cilat i boton dhe gazeta "Dielli".

Ja si shkruan gazeta "Dielli" e dates 8.3.1911: "Me 15 të Dhjetorit u kënduen në gjykatore të Durrësit letrat që paten ardhur të prishura prejri temizit të Stambollit, me 17 vazhdoi gjyqi perseri pore pa len shumë me fole të ndershmin prift atdhetar, dhe pa thirr njeri si deshmitar. E denuan perseri me dy vjet burg e 25 lira gjob. Avokati mbrojtës zoti Talib Efendiu nga Gjirokastra kerkoji të zburgosurit e Don Nikoll Kaçorrit, dhe e bani temiz për se dyti por gjyqi nuk e liroji".

→ Vizion në faqen 14

RESTAURIM/E vërteta e Manastirit të Shën Kollit në Mesopotam

Në këtë numër: ROBERT FROST, ARDHUR NGA KUJTIM MORINA; REXHEP FERRI, NDREK GJINI, RESHAT GEGA, TATJANA HAXHIMIHALI PËR HENRY MARSH, ANA KOVE PËR NAMIK DOKLEN ETJ...

D

DEBATI

"Milosao" po boton në këtë numër një akuzë të restauratorit të njohur Gega sa i përket Kishës së Shën Kollit. Mbetemi të hapur për argumentet dhe debatin që mund të përcjellë shikimi me kujdes i artikullit për këtë monument, ku përmenden edhe emra të njohur të Trashëgimisë. Tërheqim vëmendjen për gjuhën dhe normat e debatit për të dhënë një ndihmë edhe për argumente të tjera lidhur me objektet e ndryshme kulturore, që jo pak herë përfliten...

Kisha e Shën Kollit në Manastirin e Mesopotamit falsifikime, zhdukje e fshehje fazash historike dhe plagjiaturë

NGA DR. ARKITEKT-RESTAURATOR, RESHAT GEGA

Një gjoja restaurim, pompoz e në shkëlqje totale të proce durave ligjore e të etikës profesionale u realizua nxitimthi e në konspiracion në njërin nga monumentet më të shkëlqyer të arkitekturës bizantine botërore, sikundër është Kisha e Shën Kollit në Manastirin e Mesopotamit.

Duke lënë mënjanë pjesën kriminale të praktikës në zhvillimin e Prokurimit Publik për këtë monument, ku e tërë procedura u realizua me ndryshimin, fshehjen dhe falsifikimin e të dhënave, kombinuar me abuzim nga ana e institucionit përkatës, në bashkëpunim me drejtuesit e punimeve, ngjarje kjo e cila ka kaluar tashmë në organet e Prokurorisë, ne, do të sjellim të dhëna dhe argumenta teknik për dëmet e rënda që janë bërë deri tani në kurriz të vlerave monumentale e historike të këtij monumenti unik. Tërë situata teknike, për çfarë kanë bërë e tjetërsuar dhe si ishte më parë gjëndja e monumentit, gjykoheft fare lehtë nga foto të cilat vine prej vet institucioneve, si IMK dhe DRKK Vlorë apo dhe foto të publikuara nga udhëheqësi i ndërhyrjeve, Prof. Meksi, në ballafaqim këto me pamjet origjinale përpara ndërhyrjeve.

Këto katër vite që kaluan do të shënohen në historinë e trashëgimisë kulturore shqiptare si periudha kur janë dëmtuar, si asnjëherë tjetër vlerat arkitekturore, historike dhe artistike në tre nga monumentet më të vyer dhe të papsëritshëm në vëndin tone, Kisha e "Shën Mërisë" Labovë e Kryqit (shek. 10-11), "Shën Mëri" Peshkëpi (shek. 9-10) dhe "Shën Kollit" në Mesopotam (fillim shek.13). Të tre rastet janë të drejtuara në të gjithë procesin, nisur nga projekti e deri në zbatim prej Prof. A.Meksi dhe Prof. P.Thomo.

Ajo që mund të evidentohet si një risi në procesin e dëmtimeve në fjalë është se protagonist apo autor nuk janë të zakonshmit vandal dhe grabitës monumentesh, apo dhe sharlatanë që paraqiten në opinion me tituj si "studiuës", por, këtë radhë kemi në aktivitet të plot të ashtuquajturit specialist, institucione të trashëgimisë si edhe ata



Dëmi mbi Shën Koll

Dëmi mbi vlerat arkitekturore, historike dhe artistike që u implementuan mbi Kishën e Shën Kollit në Mesopotam, është i tejskajshëm në dimensionin e vet. Ndërkohë ndodhja në fjalë e përfshirë nga një nxitim i dalldisur, drejtuar nga një ambicie injorante, e shtrë dhe e ushqyer nga dëshira për të shkëlur mbi punën studimore disaveqare të tjetërkujt, pra një shkëlqje flagrante e të drejtës së autorësisë dhe pronësisë intelektuale, është një tjetër aspekt i shëmtuar e i turpshëm për ata që bënë protagonizmin në këtë rast. Jo vetëm kaq, por aventura shkoll me tutje.

të cilët kanë titujt maksimal në fushën përkatëse. Kjo situatë paradoksale e ka bërë më të vështirë të kuptohet e të besohet nga opinioni i zakonshëm, akti makabër, i cili u projektua dhe dirigjua nga vetë institucionet e trashëgimisë dhe të nominuarit Profesor.

Shumëkush do e konsideronte deklarin apo denoncimin tonë si një çështje që buron nga interesa personale. Aspak e vërtetë.

Mjafton të përqëndrohesh në argumentat teknik që ne do paraqesim, të mbështetur nga foto e dokumenta që pasqyrojnë mjaft mirë ecurinë e gjërave, dhe, për sh-

gjithë fazat dhe ndërhyrjet gjatë jetës së tij gati tetëqind vjecare.

Në shërbim të të kuptuarit sa më lehtë nga opinioni i interesuar, për atë ca ndodh me trashëgiminë tonë kulturore, po japim më poshtë, në mënyrë të përmbledhur, me shpiegimet teknike përkatëse, dëmet e realizuara së fundmi mbi Kishën e Shën Kollit në fshatin Mesopotam.

1. Dëmtimi i pare lidhet me shfarosjen e shtresës së tjugullave të shekullit 13, në pothuajse gjysmën e catisë së kupolave perëndimore, (Fig. 1). Kjo ishte një pjesë e catisë të cilën, në mënyrë fanatike e kishim konservuar e përkuruar si e vetmja parcelë e mbulesës e cila vinte nga faza e parë e ndërtimit të monumentit. Me interes ishte fakti se pikërisht kjo pjesë e saj ruante aftësitë më të mira në mbrojtjen ndaj rreshjeve atmosferike. Ne, gjatë punëve konservuese, mbi tridhjet vjecare, i kishim kushtuar vëmendjen maksimale kësaj, duke vëzhguar dhe konservuar vetëm linjat periferike pa ndërhyrë asnjëherë tek tjugullat origjinale, të cilat fatmirësisht ishin tejet të forta e të qëndrueshme. Kjo pjesë e fazës origjinale të Monumentit tashmë u zhduk dhe u zëvendësua e tëra me një shtresë industriale, të prodhuar nga kushedi cila fabrikë tullash, duke na dhënë sot një pamje karagoze të të gjithë mbulesës së Kishës së Shën Kollit Mesopotam.

2. Dëmtimi i dytë i takon një tjetër veprimi injorant apo i qëllimtë, në shërbim të tjetërsimit dhe falsifikimit të detajeve dhe pjesëve origjinale të këtij monu-

menti unik për tërë arkitekturën bizantine botërore. Bëhet fjalë për rimodelimin tërësisht të gabuar të strehëve të Kishës së Shën Kollit, (Fig.2). Vecanërisht në fasadën perëndimore, nga masakrimi i situatës origjinale dhe sajesa e kornizës së re, janë konfunduar dhe zhdukur dy faza. Faza origjinale që i takonte fillim shek. 13 dhe tjetra që i ishte mbivendosur të pares në fund të shek 13 fillimi i 14-ës. Këto janë eleminuar duke sjellë në një pamje komplet të huaj por "shumë të bukur" për syrin dhe mendjen e injorantëve që e kanë sajuar, duke e paraqitur në të njëjtën kohë linjen e saj si të ishte e importuar nga modele catish kineze. Një përcimim i vërtetë.

3. Dëmtimi i tretë vjen përsëri si pasojë e sajësive në kornizat e catisë. Tashmë janë tjetërsuar e zhdukur format dhe detajet e ulluqeve që ndanin frontonet e dritareve treshë, të cilat mbulohehen me catitë dytjeshë, (Fig. 3). Originali i tyre ishte dyfish apo trefish më i gjërë, me dy reshta tjugullash ulluk, origjinale e me gjërësi të madhe, të mbuluara në bashkimin e tyre nga një tjugull më e ngusht, vendosur përmbys. Forma që vjen pas ndërhyrjeve të fundit, jo vetëm që ka zhdukur situatën e vërtetë të rrugës për largimin e ujërave nga rreshjet por, edhe ka vështirësuar në maksimum funksionimin normal duke bërë që shumë shpejt të bllokohen për shkak të rreshjeve dhe mbetjeve që sjell ambjenti, si gjethe, pluhura etj. Ato janë ngushtuar pothuajse fare. Në formën që i kanë dhënë shpikësit apo restauratorët e këtij lloji bëjnë të pamundur mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre. Hegja qafe e situatës dhe detajeve ndërtimore origjinale, që lexoheshin shumë mirë nëpërmjet elementeve dhe formave me të cilat paraqitej korniza dhe tjetërsimet e elementeve përbërës të mbulesës së catisë, bëjnë që sot e tutje, askush të mos jetë në gjëndje të perceptojë historinë dhe format e vërteta që ka patur monumenti. Një falsifikim i "bukur" me pasojë të rëndë në kurrizin e vërtetësisë së monumentit.

4. Dëmtimi i katërt është në vazhden e ndërhyrjeve si pasojë e të cilave në përfundim rezultati është përsëri një falsifikim dhe zhdukje e qartë e fazave dhe historisë së monumentit. Në studimin




Fig. 1

PJESË ME TJEGULLAT E SHEK 13

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri mund të konceptohet si një botim relativisht i ngushtë sa i përket tematikave, pasi kishte vetëm tre argumente. E para, i kushtohet Rami Saarit, një hebreu, që përketen direkt nga shqipja, por edhe njëkohësisht poliglot i jashtëzakonshëm, njohës i mirë i shumë gjuhëve njëkohësisht. Dr. Jorina Kryeziu me skrupulozitetin e saj profesional na e kishte sjellë të plotë idenë e shfaqjes së plotë dhe të qartë të gjithë veprimtarisë së tij, që përgatiti, por edhe sjellë shumë autorë nga Shqipëria në këtë vend. Urojme që të jetë i skeduar nga shqiptarët si mik i vendit. Përkitimi i letërsisë sonë në gjuhën hebraike përbën njohjen e saj në një areal të veçantë dhe të paktë, në sasinë e përkitimeve, krahasuar me gjuhët e tjera që është përktitur ajo, ku mbizotëron përkitimi prej gjuhëve të familjes indoevropiane. Me nismën e tij vetjake, ka bërë të mundur që letërsia shqipe të njihet në këtë areal me një numër të



konsiderueshëm autorësh, shkroi Dr. Kryeziu. I jemi mirënjohës layout sepse arriti që bibliografinë ta kishte në origjinal në hebraisht, një përpjekje e bukur por jo shumë e dashur nga njeriu jonë i grafikës që e lodhi pak. Autorja na ka propozuar edhe një intervistë me të. Argumenti numër dy i takonte Suzana Roberts. Ajo është poete dhe shkrimtare, përktitese dhe veprimtare për kulturën e paqes, nga Argjentina. Jeton në Trelevë-Chubut dhe së fundi mori titullin që jepet nga Çmimi Ndërkombëtar "Atjon Zhit". Poezitë, që shoqëruan shkrimin, ishin të realizuara dhe i jemi mirënjohës dhe zotit Visar Zhit, që pranoi të bashkëpunonte dhe të ndante këto poezi. Autorja e poezive ishte e mrekulluar gjithashtu me krijimtarinë në faqet e "Milosao". Redaktori zgjodhi si përballje të tij një gjë të jashtëzakonshme, e cila lidhej me një apel që ai bëri për Amfiteatrin e Durrësit, një sfidë e kahershme, që ajo të zbulohet përfundimisht. Pak donkishoteske, por është e bukur nëse do të pranohej. Të shohim sesa do të bëhet. Numri ishte relativisht i mirë.

tonë kemi evidentuar një mori detajesh dhe shtesash që kishës i janë mbivendosur pas dëmtimeve të mëdha që ajo pësoj shumë afër me kohën e ndërtimit të saj (fundit shek.13, fillimi i shek. 14). Një nga këto shtesa që i takojnë fazës së dytë të zhvillimeve arkitekturore, pas shëmbjes së korridorit me harqe në fasada, janë edhe mbushjet në dritaret e fazës parë të monumentit dhe njëherazi hapja e dritareve të vogla në brezin e takimit të qemerit cilindrik të harkadës së dikurshme, (Fig. 4). Vëcanërisht në njërën prej tyre, dritarja treshë, e mesit në fasadën perëndimore, ku është bërë mbushje me mur dhe tregulla të cilat, nga mënyra se si ishin të vendosura, japin edhe një farë efekti artistik e në të njëjtën kohë flasin qartë për kohën e realizimit. Në këtë rast, faza e dytë ishte tejet prezente dhe domethënëse për atë se si ka qënë ecuria e jetës së këtij monumenti brilant e i papërsëritshëm. Në një kuptim më shkencor, elementet që ndodheshin në mbushjen e dritareve dhe mënyra se si ato prezantoheshin, nuk ishin gjë tjetër vec se faqe të një arkivi real e material, ku flitej qartë për historinë e Kishës së Shën Kollit në Mesopotam. Me veprimin e pastrimit të këtyre gjurmëve, bëhet e qart se drejtuesit e ndërhyrjeve, gjoja restauruese, përvec mungesës së ndjeshmërisë e kujdesit ndaj cdo detaji që mishëron monumentin në trupin e tij, kanë demonstruar qartë injorancën që kishin dhe kanë për repertorin dhe format arkitekturore e artistike të tij. Kanë qënë e janë gjithnjë të paqartë në zhvillimet dhe tipologjinë volumore, duke nisur nga fillimi i jetës së monumentit e më pas.

5. Dëmtimi i pestë lidhet me qëndrimin e pakuptimtë dhe gati idiot të rivendosijes së kontraktit në anën jugore, (Fig. 5). Gjat punimeve në fazat I dhe të II, të projektit tonë, këtë element ne e kishim hequr me qëllim që të përmirësohej situata statike e fasadës jugore të kishës duke e shoqëruar me riaftësimin e skemës konstruktive origjinale, në shërbim të së cilës, tashmë aplikua sistemën e futjes së trarëve metalik me rol të dyfishtë, në kanalet e trarëve-breza të dikurshëm, prej druri në brendësi të muraturës. Përvec kësaj, ajo që rezultoi menjëherë pas heqjes të kësaj mase muri, e cila u ndërtua në vitin 1845, ishte fakti se, aty ku mbështetej, në murin e kishës, dolën në dritë detaje arkitekturore e artistike të reja, të panjohura më parë, tepër të rëndësishme në pasurimin dhe




Fig. 3



Fig. 4

kuptimin e tipologjisë dhe historisë së monumentit. Pikërisht në këtë pjesë ndodhet vëndtakimi i dy qemereve cilindrik të mbulesave të portave të mëdha në fasadën jugore. Në të njëjtën kohë, në këtë pjesë dolën edhe dy shtresa pikturë të cilat flasin mjaft qartë për zhvillimin ndërtimor dhe fazat e kishës si dhe të kapelës, e cila u ndërtua ngjitur me të në fillim shek.14. Rindërtimi i të ashtuquajturit kontrafort, nuk është gjë tjetër vec se një veprim prej inatkorësh e injorantësh. Është një dëm i padyshimtë ndaj vlerave të monumentit, qoftë në pikpamje të fshesjes së të dhënave arkitekturore e artistike ashtu edhe një përkëqim të vënja në treqiz të situatës statike të tij, për rastet e lëkundjeve sizmike të mundshme. Është një veprim që nuk ka asnjë lidhje me profesionin e mirfillt të restauratorit, studiuesit dhe kuratorit ndaj vlerave që ka një monument kaq i rallë sikundër është Kisha e Shën Kollit në Mesopotam.

Në shërbim të vënies në dukje të veprimeve të llojit që listuam më sipër, ka edhe të tjerë raste apo



Fig. 2

Apeli për objekte të tjera

Jam i sigurt se do të ketë një vëmendje të veçantë, si për rastin në fjalë ashtu edhe për përdhosjet të perlave të tjera të arkitekturës bizantine në vendin tonë. Në këtë listë janë edhe Kisha e Shën Mërisë Labovë e Kryqit, e cila u masakrua një vit më parë duke e rrëpuar, shpërfytyruar dhe tjetërsuar në format origjinale të saj, e pasuar kjo nga Kisha e Shën Mërisë në Peshkëpi, e cila nuk mund t'i shpëtonte fushatës së shfarrosjeve dhe falsifikimit të formave arkitekturore. Kësaj të fundit i hoqën të gjithë materialin formues të mbulesës origjinale të shekujve 9-10, si pitosa etj, me idenë injorante se ishin vendosur nga ndërtuesit aty pa dashje apo kot.




Fig. 5

pjesë të Kishës së Shën Kollit në Mesopotam, ku janë prezent dëmtime të vlerave dhe prishje të informacionit historik-arkitekturor e artistik, për shkak të një gjoja restaurimi dhe mungese totale ndjeshmërie dhe njohurie. Një analizë më e thelluar dhe egzaminim teknik e fizik, duke paqur si qëllim nxjerrjen në dukje të të gjithë asaj ca ka ndodhur mbi Kishën e Shën Kollit në Mesopotam, do të përpilohet në një material më të plotë dhe do prezantohet, qoftë në organet përkatëse shqiptare që kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave kulturore ashtu edhe ato ndërkombëtare, të interesuara për të promovuar kriteret restauruese në tërësi. Ky hap është i domosdoshëm e në shërbim të mbrojtjes nga ndërhyrjet vandale, të veshura me petkun e një procedure zyrtare gjoja restauruese, si pasojë e të cilave shfarrosen vlerat origjinale e falsifikohet situata dhe historia e monumenteve.

Jam i sigurt se do të ketë një vëmendje të veçantë, si për rastin në fjalë ashtu edhe për përdhosjet të perlave të tjera të arkitekturës bizantine në vendin tonë. Në këtë listë janë edhe Kisha e Shën Mërisë Labovë e Kryqit, e cila u masakrua një vit më parë duke e rrëpuar, shpërfytyruar dhe tjetërsuar në format origjinale të saj, e pasuar kjo nga Kisha e Shën Mërisë në Peshkëpi, e cila nuk mund t'i shpëtonte fushatës së shfarrosjeve dhe falsifikimit të formave arkitekturore. Kësaj të fundit i hoqën të gjithë materialin formues të mbulesës origjinale të shekujve 9-10, si pitosa etj, me idenë injorante se ishin vendosur nga ndërtuesit aty pa dashje apo kot. Përpos dëmit në mbulesë, nëpërmjet manisë së kruarjes e prekjës, deri edhe bojatisjeve karagoje në sipërfaqen e fasadave, u shdukën e tjetërsuan të gjithë elementet të cilët flasin për zhvillimet e fazave arkitekturore që lexoheshin më parë në fasada. Pasqyrimin e

dëmeve për rastet e mësipërme do i takoj publikimeve të tjera.

Dëmi mbi vlerat arkitekturore, historike dhe artistike që u implementuan mbi Kishën e Shën Kollit në Mesopotam, është i tejskajshëm në dimensionin e vet. Ndërkohë ndodhja në fjalë e përfshirë nga një nxitim i dalldisur; drejtuar nga një ambicie injorante, e shtyrë dhe e ushqyer nga dëshira për të shkelur mbi punën studimore disa vjeçare të tjetërkujt, pra një shkelje flagrante e të drejtës së autorësisë dhe pronësisë intelektuale, është një tjetër aspekt i shëmtuar e i turpshëm për ata që bënë protagonizmin në këtë rast. Jo vetëm kaq, por aventura shkoi me tutje. Për aq sa kemi vënë re nga fotot e publikuara, në drejtim të idesë së ndërhyrjes për konsolidimin e strukturës së Kishës së Shën Kollit në Mesopotam, gjejmë elemente të plagjiaturës apo vjedhjes së idesë dhe teknikës që ne kemi aplikuar më parë në një pjesë të mirë të strukturës së monumentit.

Në këtë rast është shmangur ideja dhe rekomandimet e paraqitura në projektin abuziv, me Vendim nr. 32 i KKR-së në vitin 2015, i përpiluar nga të njëjti protagonist, projekt të cilin ne e kemi kallzuar penalisht dhe ndjekur në rrugë ligjore, për mbivendosje dhe cilësi kriminale. Është i njëjti projekt i cili u bë pjesë e procesit të Prokurimit Publik, tek i cili janë verifikuar fallsifikime dhe manipulime në të dhënat e monumentit, fakt ky i cili është paraqitur në Prokuroritë përkatëse për ndjekje dhe hetimet e rastit, si edhe u bë i njohur në opinion publik nga një emisioni investigativ, (Fiks Fare, 19 Tetor 2018, Pjesa 2).

Në këtë rast, protagonistët apo drejtuesit e punimeve mbi monumentin në fjalë kanë preferuar të lënë mënjane idenë e tyre për ndërhyrjet konsoliduese, koncepte këto që i kishin radhitur në projektin e tyre skandaloz të cituar më sipër. Nga aq sa na jepet në pamjet e përfundim punimeve, kujtojmë se kanë kalluar në aplikimin e konsolidimit sipas teknikës dhe idesë tonë, gjë të cilën ne e kishim realizuar në monument, për gjat dy fazave të mëparshme. Shkurt, kanë lënë mënjane idenë e tyre dhe janë lëshuar në shtratin e kopjimit apo vjedhjes së idesë tonë, pa u bërë aspak të kujdesshëm dhe merak se po cënonin konceptin dhe kontributin studimor e teknik të tjetërkujt. Një tjetër hap ky i shëmtuar nga pikëpamja e etikës dhe të drejtës së autorit, i cili do të ketë zhvillimet e mëvonshme në rrugë ligjore.

E ESE

NGA REXHEP FERRI

1.
Mur nëmur
Nuk më mban çekiçi
Gozhda më mban

Ky mendim papritur më erdhi dhe po e shkruaj ashtu si më erdhi, pa i shtuar asnjë fjalë e asnjë frikë nga frika.
Për pyetjet e shpirtit njerëzor po të ishte gjallë sot Skënderbeu çka mund të bënte?
Lufta e Parë e Skënderbeut mua nuk më kujtohet, por lufta e fundit po.
Për jetën e njeriut nga të gjitha anët, koha shpesh mbetet pa fjalë.
Fund e krye me një histori të pakuptueshme. Me një ngacim brenda zjarrit.
Kur jeta nis e merr teposhtëzën.
Për jetën me sfida të larme çdo gjë pret urrejtjen e vet.
Në teatrin e shëmtuar të patriotëve sojlinj, për ta kuptuar magjinë tërheqja e vëmendjes po na lë pa fjalë.
Unë, megenëse isha me kilometra larg për të bërë një pushim, çerdhe mbi pemë, me mure prej drite, prej ajri në prehërin e nënës mbështeta kokën.
Pashë një ëndërr:
Me qëllim të mirë urrejtja ka të drejtë, jeta është shumë e shtrënjtë, nga një vend më larg në një vend më poshtë nuk kërkon as falje, as premtime, as përhëndetje.
Për ta mbushur një boshllëk, jo me qëllim për ta zëvendësuar me një boshllëk tjetër.
Me famën kur të vdekurit ishin të gjallë, veten e gjeta te rrënojat e Kullës së Gjyshit.
Aty tani nuk kemi më kohë për miqësi.
Gjatë njëqind vjetëve të fundit i kemi humbur katër luftëra. Gjatë atyre katër luftërave u pamë e s'u pamë.
Këtë histori që as sot nuk ka të ardhme, gjaku nuk e meriton.
Maskarallëqet morën dhenë.
Veç pak!...

2.
Gjatë kohës së komunizmit të Enver Hoxhës, ditën e tretë në Tiranë e theva një vijë të trashë dhe e vizatova një vijë të hollë.
Rastësisht nuk e vizatova.
Ajo ishte fjala dhe heshtja e njeriut të vetmuar.
Shoferi që më shoqëronte më tha:
-Shoku Rexhep, vijën që e vizatove fshije.
Unë e shikova. Ia dhashë gomën e i thashë:
-Fshije ti!
Shoferi mori gomën, e fshiu vijën...
Gjatë rrugës për në Krujë më pyeti:
-Çka po mendon?
-Asgjë më afër e asgjë më larg, - i thashë.
Jeta është me pyetje e pikëpyetje e bukur.
Për çka janë pyetjet, pikëpyetjet, kur bie nata?...
Populli i ka hapur veshët.
Pret të dëgjojë kush po flet.
Ka filluar edhe veten të mos e njohë e mos ta dojë.
Larg gjithçkaje.
Përveç pritjes.
Vetëm rrënojat e legjendave i kupton më mirë...
Me këmishë e pa këmishë.
Me arkivol e pa arkivol.
Mos e mashtroni veten.
Kjo është jeta që na pret.
Jeta që na mëson ta urrejmë njëri-tjetrin.
Fërkoni sytë!
Për ta ndryshuar botën, lufta nuk i njeh kufijtë.
Me pakënaqësinë tonë kemi shumë mundësi, me kufij e pa kufij.
Jeta vetë e kërkon dhe vetë le ta vuajë.
Me zjarr që na shpëton nga zjarri.

3.

Një përsiatje në karakterin thellësisht metafizik, ku atdheu, nocionet, morali futen në një qerthull, ku është vështirë të gjykosh. Akademikun ia lehtëson puna në shkrimin e esesë njohja e disa fushave dhe abstragimi i lehtë i kuptimit të jetës, falë përvojës dhe gjykimit të ftohtë...

NJË SY DHE NJË PIRAMIDË



Te varret, në mes të Ballkanit nuk po e njohim as vetveten.
Kam ardhur sot për të mos u larguar nesër.
Nga rrënojat e Trojës e te rrënoja e Trojës Gjarpëri e puthi Helenën.
Në varr për të pushuar.
Mjafton nata nga nata. Për t'u parë mes dashurisë dhe sfidave, mjaft me këto mashtrime të këngëve patriotike.
Sa më shumë që i afrohem Hënës, aq më pak kemi se çka të flasim për Hënën.
Kur jetohej me çmimin e famës është e pamundur ta mbushim ditën me gëzime.
Nuk e kuptojmë pse nuk na doli e mirë asnjë histori.
Duke dashur të krahasohemi me yllin e afërt, verbërisht përpiqemi ta kuptojmë zemrën e humbur.
Kur vazhdon loja me zjarrin, jeta na vie si mashtrim dhe shkojmë në mal për ta takuar gjarpërin.
Për tuj kërkujmë pak helm.
Për ta fituar zemrën e luanit, pa e pyetur as jetën, as vdekjen.
Ndodhi ajo që ndodhi.
Nga thellësitë e shpirtit.
Me një këngë, me një pllakë të prishur gramafoni, kur heshtja flet më mirë, për fjalën asgjë.
Të kuptosh se kush të plagosë e kush të shëron.
Çdo të thotë kjo?
Shpirt të lutem ke durim!
Më mire është të ruhesh e të mos bësh buallëqe.
Dhe duhet të flasim pse s'kemi për çka të flasim.
Mesnatës dhe ditës, as ulurimë e ujkt nuk dëgjohej.
Ndodh ajo që ndodh.
Nata mbushet me ëndrra.
Dita me mashtrues sojlinj.
Ne të tjerët kërkujmë një pushim.
Duhet të nisemi.
Të gjejmë fajtorë.
Betejë së ligjeve t'i flasim për ligje me të cilat dikush duhet të denohet.
Shkurt e shqip, të vazhdojnë hetimet.
Për një moment të cakturn kur duhet të ndalemi.
Të dijme pse të ndalemi.
E vetmja gjë fisnike që na ka mbetur është të dijme pse jetojmë.
Kur kthehemi e prapë shkojmë.

4.
Mes Detit të Zi e Detit të Vdekur, me vite e shekuj historia na vinda si thikë pas shpine.
Pas shumë fillimeve i humbëm të gjitha luftërat.
Kujt i u kemi falënderuar nuk e di.

Ata që na kanë lexuar mendjen kanë shkruar më larg se larg.
Gjatë luftës së fundit, a jemi takuar me zjarin që dogji malin?
Tani më s'kemi kohë për asgjë më të mirë.
Zgjedhja më e mirë është prirja.
Më falni, po ku mbeti përshëndetja me grushin lart të komunistave? Me një emër që përsëritet, na doli si provokim!

Ndoshta e kishim tepruar.
Kemi edhe disa thasetheme se nuk e meritojmë një jetë më të mirë.
-Korrigjoheni të kaluarën. - na tha Dervishi që flinte nën Urën e Vezirit.
Me një mblyllje në vetvete nuk jam i sigurt se do të pyesë dikush se e kishim pasë dajën bajraktar:
Rrugës sa kilometra është jeta, as unë e as Dervishi që flente nën Urën e Vezirit nuk e dijmë.
Jetën e mori era e fjalën ëndrra mashtruese.
Me një ëndërr mashtruese koha e ka fshehtësinë e vet.
Nuk e çelë gojën pa rryshet.
Njëqind vjet Biza... Biza...
E luajtë të njëjtën lojë.
Pesëqind vjet Turra... Turra...
Binte borë e bardhë, në të pamë e kuqe...

5.
Patriotët sojle dhe pas luftës pa fije turpi vazhdojnë lojën me letra mashtruese.
Populli nuk ka çka të rrezikojë më shumë.
Me fatin e vet po e kalon jetën nga dita në ditë.
Nën mëshirën e legjendave kanë kaluar dymijtë e pesëqind vjet kur Leka i Madh
Pushtoi Egjiptin.
Nga ajo kohë e nga ajo luftë e nga ato rrënoja e ato legjenda dolën në dritëshumë mite.
Perëndia i Besimit shumë çka pa.
Nga mbidoza e besimit kishte rënë në gjumë të thellë.
Kur është zgjuar është bërë më i fortë.
E pa se gjumi e kishte tradhtuar.
Vonë, shumë vonë, duke kaluar kufirin, e humbëm rrugën, edhe për njëqind vjet të ardhshme.
Nga të gjitha ato e këto luftëra.
Nga ato e këto rrënoja, për ta përdorur magjinë, dollari amerikan e ka të vizatuar një sy dhe një piramidë.

Janar, 2019

REVIEW

Bashkëpunëtorja e hershme e "Milosao" na ka sjellë disa mendime për librin "Rrëfime - jeta si kirurg i trurit" nga Henry Marsh. Motivimi i tij është puna, një punë cilësore, që përpiket t'ua fusë në shpirt edhe bashkëpunëtorëve e nxënësve pasues me shembullin që jep në realizime operacionesh të vështira, shpeshherë edhe në kushte jo të përshtatshme.

NGA DR. SHK. TATJANA HAXHIMIHALI

Një karrierë e jashtëzakonshme në fushën e neurokirurgjisë e autorit të librit Henry Marsh. Titulli modest kurrsesi s'i jep lexuesit përfytyrimin e amplitudave tronditëse të jetës së një mjeku për të cilin mjeshtria delikate e ndërhyrjes në trurin e njeriut është "shkenca e pasigurve dhe arti i mundësive". Edhe vetë autori është i thjeshtë në përshkrimin me sineritet të thellë të jetës së tij profesionale. Çuditërisht ai merret gjatë me zgjidhjet e gabuara që ka bërë gjatë operacioneve në trurin e pacientëve, po aq sa me ato të sukseshmet. Sepse suksesit të bën mendjelehtë, kurse nga gabimet duhet të mësojmë, natyrisht kur ato ia pranojmë vetes. Është përvoja e një mjeku të ngritur nga shkallët më të ulëta të shërbimit shëndetësor edhe pas studimeve në Universitetin e Oksfordit dhe diplomimit për mjekësi në spitalin Royal Free të Londrës, deri në lartësinë e neurokirurgut të vlerësuar lart me tituj e cmime. Njeri praktik i mbështetur nga

guximi për t'u përballur me vështirësitë, me një përpjekje të palodhur për të dhënë përvojën e tij duke punuar me fisnikëri e durim edhe pas daljes në pension, në spitale vendesh të varfra si Nepali dhe Ukraina etj. Marsh ka dhënë edhe në Shqipëri ndihmën e tij duke asistuar, si gjithnjë në operacione të ndërlikuara të trurit të njeriut.
Motivimi i tij është puna, një punë cilësore, që përpiket t'ua fusë në shpirt edhe bashkëpunëtorëve e nxënësve pasues me shembullin që jep në realizime operacionesh të vështira, shpeshherë edhe në kushte jo të përshtatshme. Puna për të është burim kënaqësie edhe atëherë kur me vegla të thjeshta bën meremetimet e shtëpisë së tij, merret me punime druri në kohën e lirë etj. Të jetë kjo trashëgimi nga prindërit e vet? Sepse siç thotë autori, çdo të mirë e kam vetëm për ty tyre...
Me interese të veçantë në libër janë përsiatjet e neurokirurgut që kaq herë ka prekur me dorë materien gri në kafkën e njeriut, për të na dhënë mendime bindëse mbi funksionet e rëndësishme të lobeve të trurit, pëzmatimin e tyre në raste insultesh, aneurizmesh etj. Duke na bërë të gartë se sa të vështira janë përmirësimet pas

A

ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Kush kalon ditët e fundit para Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "Pjetër Arbnori apo ish-Muzeut "Enver Hoxha", do ta kapë një trishtim instiktiv. Dera hyrëse dhe mjedisi frontal i të ashtuquajturës "Piramidë" janë shkatërruar krejtësisht dhe bjerria vazhdon me forcë për çdo ditë. Në atë që jemi mësuar në kryeqytetin tonë, zakonisht prishjet e paraprijnë modifikimeve ose shkatërrimeve. Trishtimi justifikon edhe pafuqinë e njerëzve për të ruajtur gjërat e mira të qytetit tonë, por edhe bjerren pa kthim të një godine që është ende e re dhe kurrë nuk iu gjet justifikimi i dur-hur funksionalitetit të saj.

Duke kaluar pak në retrospektivë, publiku kryeqytetas u trand realisht, kur gati tetë vjet më parë, në përçarjet e atëherëshme politike, një vendim i qeverisë Berisha, vendosi të prishë Ngrëhinën muzeale dhe ta kthente në ndërtesën e re të parlamentit. Siç ndodh rëndom u gjenden arkitektët që e mbështeten plotësisht dhe e deklaruan padobinë e objektit, të tjerët që sollën maketet e godinave të reja mbi shkatërrimin e saj (u përgatitën disa syresh në sallat e Kuvendit) u shtuan kinsët që e identifikuan si mbeturinë të komunizmit, ndërtesën e vjetër gati 30-vjeçare (!!), kurse një masë e madhe publiku nënshkroi një peticion në mbrojtje, për të mbajtur gjallë, një prej simboleve të kryeqytetit.

Ish-muzeu "Enver Hoxha" u përrua në

Debati për "Piramidën", paqka se është stërfulur se do të bëhet një qendër e madhe inovacioni, na sjell apelin e madh që kjo godinë duhet të bëhet Bibliotekë Kombëtare, në mënyrë që të justifikojë rëndësinë e vet, por edhe t'i japë zgjidhje problemit pa zgjidhje të këtij institucioni. Për fat të keq, megjithë punën gati heroike të punonjësve të saj, Biblioteka e sotme Kombëtare vuan pamundësinë e kryerjes si duhet të funksionëve të saj për shkak të vendit, por edhe hapësirave të duhura...

"Piramida", muzeu më i nëmur në botë!

vitin 1988 dhe u realizua nga arkitekti i ndjerë Klement Kolaneci dhe bashkëshortja e tij, Pranvera Hoxha, respektivisht dhëndri dhe e bija e personazhit, të cilit i ishte kushtuar ngrëhina. Arkitekti, në të gjallë, në kohën e Demokracisë do ta përmendte shpesh se godina mund të modifikohej lehtësisht për funksione të tjera, kurse sa i përket formës së saj arkitektonike, që gjatë lëvizjes studentore të Dhjetorit 1990, u pagëzua si "Piramida", ai e shpjegonte lehtësisht dhe qartë se kishte formën e një shqiponje.

Godina e mrekullueshme sa i përket hapësirave ruan ende një formë harmonioze, kurse arkitektët tanë me këtë zgjidhje tejkalojnë një nga detyrat e vështira të objekteve të këtij lloji. Për specialistët godina është e vlerësueshme në çdo kohë dhe kjo i bente ndër historisë sonë të arkitekturës, paqka se shumë kolegë të Kolonecit do ta hidhnin turpërisht poshtë. Paradoksalisht, shumë syresh gjenin gjithnjë justifikime për godinat në epokat historike që nga periudha e perandorisë osmane, monarkisë, fashizmit, periudhës sovjetike, nuk mundeshin të justifikonin fatin e godinës të ngritur me aq shumë vështirësi dhe me kosto të lartë për

vendin.

Autori mendon sërish se Debati për "Piramidën", paqka se është folur do të bëhet një qendër e madhe inovacioni, duhet të risjellë apelin e madh që kjo godinë duhet të bëhet Bibliotekë Kombëtare, në mënyrë që të justifikojë rëndësinë e vet, por edhe t'i japë zgjidhje problemit pa zgjidhje të këtij institucioni. Për fat të keq, megjithë punën gati heroike të punonjësve të saj, Biblioteka e sotme Kombëtare vuan pamundësinë e kryerjes si duhet të funksionëve të saj për shkak të vendit, por edhe hapësirave të duhura. "Apelet e zyrtarëve të saj, kushtet jo të mira me të cilat mirëmbahen sot ekzemplarët e rralla, por edhe vëllimet e shumta të dëmtuara kanë nxjerrë imperativin, që godina e Bibliotekës duhet të ishte dikund tjetër. Duket se mungesa e zërit për të përfaqësuar si duhet këtë problem i rëndon të gjithë institucionet tona të kulturës, që nga Ministria e Kulturës që duhen vlerësuar nga ana tjetër për rezistencën që i bënë Berishës dhe strukturave të tij për të prishur; por në rresht të tjerave", kemi shkruar pak kohë më parë.

Nuk do shumë punë, paqka se vendi ynë

në këto momente ka probleme të mëdha. Ndoshta me një modifikim fare të lehtë arkitektonik, Piramida mund të bëhej fare mirë Biblioteka Kombëtare, duke harmonizuar të gjithë interierin, mjediset e saj ndihmëse, por mbase edhe ndonjë shtesë e çfarëdo rëndësie mund ta ndihnte shumë objektin, duke na dhënë një simbol identiteti kulturor, që Shqipëria nuk e ka sot e kësaj dite. Një shembull i bukur është ngrëhina e Bibliotekës së Prishtinës, e cila përcjell në format e saj dhe një simbolikë të duhur për qytetin. Duke respektuar zgjidhjen, kjo bibliotekë mund të ofrojë dhe alternativat e jashtëzakonshme të kibernetikës, duke i vendosur brenda bibliotekën dhe duke paraprirë me zgjidhjet e saj.

Biblioteka Kombëtare u inncua më 10 Korrik 1920 nën drejtimin e prof. Mati Logoreci, që u komandua asokohe nga Ministria e Arsimit. Në fillim ishin vetëm 3000 vëllime në ngrëhinën e parë që shërbeu si bibliotekë, kurse sot ajo ruan thesarin kulturor të shkruar të kombit tonë ndër shekuj. Në të gjendet libri më i vjetër i shqipes (kopja e riprodhuar nga At Justin Krota e "Mesharit" të Gjon Buzukut). Karl Gura kuqi do t'i jepte një frymëmarrje dhe si drejtor i parë i përkohshëm do të bëjë inaugurimin simbolik të institucionit më 28 nëntor 1922. Kjo është historia, por përjetësia e këtij institucioni nuk mund të jetë kurrë aty, të paktën me fytyrën që ka Shqipëria pas 110 vjetësh ekzistencë si shtet.


Për fat të keq, katandisja e këtij institucioni në këtë formë është një kambanë e trishtit për të gjithë kulturën shqiptare.

(Milosia)

"Rrëfime - jeta si kirurg i trurit" nga Henry Marsh

goditjeve të rënda cerebrale, kur truri me brishtësinë e tij ka shumë më pak aftësi se pjesët e tjera të trupit për t'u rikuperuar. Megjithatë bëhen operime me sukses (përshkrimet e tyre janë si të një tregimtari të sprovuar!). Por gjatë punës së një mjeku operator ndodhin shpesh edhe vështirësi në komunikimin me pacientët dhe familjarët, për të cilët kirurgu-njeri duhet të jetë i kujdesshëm dhe mirëkuptues.

Marsh, me sa duket, edhe si nxënësi i shkollës angleze, që nga koha e Ëalter Scot-it, i pari në periudhën e re industriale të Anglisë që shpjegoi se s'mjafton të njohësh vetëm të tashmen tek njeriu, por dhe të shkuarën, në këto rrëfime tregohet këmbëngulës në kërkesën e tij që të mos bëjë asnjë operacion pa e njohur mirë pacientin, mundësisht CV e tij. Me përkujdesje, por jo me empati. Si mjekë duhet ta ndryshojmë ndjenjën e natyrshme të empatisë (të kuptuarit e gjendjes emocionale të tjetrit) nëse duhet të funksionojmë sic duhet, vë në dukje ai, sepse empatia është më e fortë se simpatia. Po edhe interesimi i pakët është i palejueshëm. Për mendimin tim, si shkruase e këtyre radhëve, nuk është e lehtë të gesh një mendësi të tillë të mjekët tanë shqiptarë, të cilët shpesh nisen nga pozita e privilegjuar në krahasim me pacientin. Ashtu siç thotë Marsh, për disa nga kolegët e tij të rinj, në spitalet ku ai ka punuar, që sillen me mendjemadhësi, duke mos u kushtuar



vëmendjen e nevojshme të shtruarve dhe shoqëruesve të tyre...

Mbi të gjitha, me vlera të veçanta, jo vetëm për specialistët e fushës siç e përmendëm më sipër, janë konkluzionet dhe përsiatjet e kirurgut (Marsh ka studiuar

edhe për filozofi në universitetin e Oxfordit), nga eksperiencia e tij e gjatë e punës, për aspekte të marrëdhënieve materie-ndërgjegje, mbi proceset që ndodhin në botën e jetës dhe të vdekjes si dhe aludimet për një jetë të përtëjme. Ai thotë se truri i njeriut vërtet është material, po ka aftësinë për të bërë abstraksione idesh. Të qenit i vetëdijshëm na dallon ne si njerëz nga bota shtazore dhe se pikërisht këtu qëndron dhe

Përsiatjet e neurokirurgut

Me interes të veçantë në libër janë përsiatjet e neurokirurgut që kaq herë ka prekur me dorë materien gri në kalfkën e njeriut, për të na dhënë mendime bindëse mbi funksionet e rëndësishme të lobeve të trurit, pezmatimin e tyre në raste insultesh, aneurizmesh eji. Duke na bërë të qartë se sa të vështira janë përmirësimet pas goditjeve të rënda cerebrale, kur truri me brishtësinë e tij ka shumë më pak aftësi se pjesët e tjera të trupit për t'u rikuperuar. Megjithatë bëhen operime me sukses (përshkrimet e tyre janë si të një tregimtari të sprovuar!). Por gjatë punës së një mjeku operator ndodhin shpesh edhe vështirësi në komunikimin me pacientët dhe familjarët, për të cilët kirurgu-njeri duhet të jetë i kujdesshëm dhe mirëkuptues...

forca shtytëse e arritjeve të njerëzimit. Po kjo vetëdije, ndërgjegjja jonë, zhvillohet në trurin e njeriut, që është një përbërje elektrokimike e përkohshme. Individit vetë është i përbërë nga mijëra copëza informacioni që shpërbëhen me vdekjen e tij. Informacioni, siç thonë edhe fizikanët është material, pra pas vdekjes do të humbasë. "Kur sheh dëmtime të rënda të trurit e ke të vështirë të besosh në zot!". Një gjykim materialist i Henry Marsh-it "që ka zhveshur meningjet për të zbuluar botën...tmerrësisht tërheqëse të neurologjisë".

Janë të mrekullueshme mendimet e një njeriu që ka parë raste të pafundme njerëzish në prag të jetës dhe vdekjes, të atij që e di se dhe vetë dikur do të jetë në një pozitë të tillë. Ne jemi të dënuar nga e kaluara jonë evolucionare, që t'i drahemi vdekjes. Gjithnjë shpresojmë se do të jemi nga të zgjedhurit, që do të jetojnë afatgjatë, te grupi i atyre që do të jetojnë më shumë dhe jo më pak, sipas shpërndarjes normale që bëjnë statisticienët. Megjithatë, thotë Marshi që e ka vënë sentencën e Montaignes si epigramë në krye të librit, "duhet gjithnjë sapo të na afrohet koha, të jemi të veshur e të mbathur dhe të gatshëm për të ikur...". Dhe lajtmotivi që përshkon gjithë librin vjen në fund jo si një happy end po si një konkluzion optimist i natyrshëm i një jete të mbushur me jetë: "Më mjafton të jem mirë e të kem ende punë për të bërë e ta ndjej veten të dobishëm".

Neokirurgu ynë i njohur Mentor Petrela në parathënie e koncentruar shpjegues që shoqëron librin përmend një sentencë të Niçes për të vlerësuar autorin e "Rrëfimeve": "Të shkruash duhet të jesh mjek dhe të njohësh filologjinë". Kjo kërkesë do të duhej të vrente edhe për përkthimin, që është kthimi apo rishkrim i materialit në gjuhën përkatëse. Në këtë drejtim autorët e përkthimit (M. Petrela dhe F. Dashi)

A

ARGUMENTIM

NGA NDREK GJINI

Vijon nga faqja 1

Imzot Nikoll Kaçorri ishte njeri nga arkitektet kryesor të bërjes së shtetit të ri Shqiptar. Memorandumi që ai i dergon Mbretit të Austro-Hungarisë Franz Jozefit vetëm dy javë para se shpalljes së Pavarësisë e deshton kete me se miri.

Sic dihet në fillim që vendosur që pavarësia të shpallej jo në Vlore, por pikërisht në Durrës, ne gytetin ku Imzot Nikolle Kaçorri zhvillonte veprimtarinë e tij. Por autoritetet turke lajmeruan telegrafikisht komanden e Janines dhe u pergatit me shpejtesi një njesi ushtarake turko-greke që me çdo kusht të mos lejonte realizimin e këtij akti. Xhonturqit madje urdheruan vrasjen e organizatoreve të këtij akti. Ne kete menyre delegatet në menyre tejet konspirative marrin rrugen e Vlores.

28 Nentor 1912, pasi mberrijne atje shumica e delegateve, në Vlore mbahet Kuvendi i Pavarësisë. Ismail Bej Vlora zgjidhet kryeminister dhe Minister i Puneve të Jashtme, dhe Imzot Nikolle Kaçorri nënkryetar i Qeverisë.

Me që Ismail Bej Vlora u zhgjedh edhe si Minister i Puneve të Jashtme pjesen më të madhe të kohës e kalonte jashtë Shqipërisë, (ai ka qendruar në Shqipëri vetëm 42 ditë), lirisht mund të thuhet se Imzot Nikolle Kaçorri, luante rolin e kryeministrit në Shqipëri.

Ja çfare shkruante më 12 nentor 1912 Imzot Nikolle Kaçorri, në memorandum të dërguar Mbretit të Austro-Hungarisë Franz Jozefit I: "Shume të veshitire e të rrezikshme janë keto ditë për ne shqiptarët e për nanën tonë Shqipërinë që të katër shtetet e Ballkanve po dojnë me e përpi e me coptu". Dhe të mos harrojmë faktin se ky memorandum i që dërguar Mbretit të Austro-Hungarisë Franz Jozefit I gjashtëmbëdhjetë ditë para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë së Shqipërisë. Duhet të vihet në dukje fakti se përveç Imzot Nikolle Kaçorrit, nënkryetar të këtij memorandumit janë edhe zoterinjte, Mustaf Asim Kruja, Rexhep Mitrovica, Fuad Toptani, Abdi Beu, Murat Toptani, Sali Gjuka dhe Bedri Pejani. Ata pemes këtij

Autori na sjell memorandum të Dom Kaçorrit, përcjellë mbretit të Austro-Hungarisë, Franz Jozefit I: "Shume të veshitire e të rrezikshme janë keto ditë për ne shqiptarët e për nanën tonë Shqipërinë që të katër shtetet e Ballkanve po dojnë me e përpi e me coptu". Dhe të mos harrojmë faktin se ky memorandum i që dërguar mbretit Franz Jozefit I gjashtëmbëdhjetë ditë para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.



Franz Jozefi I



Memorandumi i Imzot Kaçorrit dërguar mbretit të Austro-Hungarisë, Franz Jozefi I

FAKTE RRETH IMZOT KAÇORRIT

- Imzot Nikolle Kaçorri u lind në vitin 1862 në fshatin Kre i Bajrakut të Lures
- Me 1882 mbaroi kolegjin urban për retorikë e gramatikë.
- Me 1882 - 1888 studioi në Rome në kolegjin urban duke kryer 4 vjet për gramatikë dhe 2 vjet për retorikë.
- Me 1888-1892 studioi për teologji, filozofi e shkenca politike në Universitetin "Zeking" të Zyrihut në Zvicër.
- Me 1893 vjen në Shqipëri e sherben fillimisht meshtar në Delbinisht.
- Me 1893 - 1916 sherben në arkiveshkvine e Durrësit.
- Me 1907 kryetar nderi i klubit "Vllaznia".
- Me 1909 në klubin "Bashkimi".
- Me 1908 dhe 1909 merr pjesë në kongreset e Manastirit e Elbasanit.
- Me 1910 - 1911 u denua me 2 vjet burg "për nxitje kundër ligjeve të shtetit xhonturk".
- Me 1912 i bashkohet nismes së Ismail Bej Vlores. për shpalljen e pavarësisë.
- Me 1912 delegat i Durrësit në Kuvendin e Vlores.
- Me 4 dhjetor 1912 - 30 mars 1913 zëvendëskryeminister i qeverisë së parë të Shqipërisë.
- Vdiq në Vjenë më 29 maj 1917.

"Rrëfime - jeta si kirurg i trurit" nga Henry Marsh

→ Vijon nga faqja 19

duhjet të kishin qenë më të kujdesshëm për të sjellë në një shqipe të pastër dhe gramatikisht korrekte materialin, që në disa raste të për të dëshiruar. (Vërejmë nga shënimet shoqëruese të librit, pas frontepicit, se materiali i përkthyer ka dalë nga shtypi pa u parë as nga një korrektor e jo më prej një redaktori, që mund të kishin lehtësuar edhe punën e vështirë të përkthyesve). Duket qartë se duke e vlerësuar lart përmbajtjen dhe të tërhequr prej saj, mjekët përkthyes nuk i kanë vënë rëndësi gjuhës së përkthimit. Po japim vetëm disa shembuj. 1) Siç janë rastet kur përkthimi është bërë sipas sintaksës së gjuhës angleze që nuk mund të jetë e ngjashme me atë të shqipes. Ka ndodhur kur kryesisht fraza fil-

lon me fjali të varura dhe fjalia kryesore mbetet në fund, çka e bën atë të sfurcuar. Edhe përsëritja disa herë e së njëjtës fjale në të njëjtin frazë, kur fare bukur mund të gjendej i barasvlefshmi i saj, e rëndojnë atë. 2) Teksti i përkthyer mund të ishte pastruar nga shumë fjale të huaja turqizma, italianizma, madje anglicizma, apo edhe dialektalizma që i kanë shumë të sakta përgjegjëset në shqip (i jap karar = vendos, kallëp tradicional = mënyrë tradicionale, me zor = me vështirësi, sikletos = shqetësor, refuzoj = kundërshtoj, inefficiencë = paaftësi; ndeshim përdorim pa vend të dialektalizmeve si: i shakmisur = i ngatërruar, bojë për trup njeriu, on-call = mjek roje (pranë telefonit) etj. etj. 3) Nga një kalim i sipërfaqshëm i tekstit shpeshherë përkthehet në shqip fjala jo në kuptimin e duhur (një shembull tipik kur

library përkthehet librari dhe jo bibliotekë siç del nga konteksti dhe është kuptimi në anglisht, ose kur padashur përdoret një koncept për një tjetër: gjendje për gjindje, ose statut për status) etj. 4) Në libër ka shumë raste kur cilësorët e përdorur pa vend e bëjnë të pasaktë mendimin: karrocë kashte për karrocë me kashtë, Bujtina e natës së dytë për Bujtina ku ndejtëm natën e dytë, ose pyeta gjerësisht sallën, si pyetet gjerësisht? Ose Leksioni im fliste, si mund të flasë leksioni? Ishim takuar vetëm shkurt domethënë ishim takuar për një kohë të shkurtër etj. 5) Rëndom trajtat e shkurtër të përemrave vetorë janë përdorur në mënyrë të ngatërruar p.sh. ju bashkova grupit për ju bashkova grupit etj. 6) Nga një pakujdesi ortografike ndodh që të mos shprehet në mënyrë korrekte mendimi: p.sh.

nuk del i qartë dallimi midis perëndimit si anë e horizontit dhe Perëndimit si vendndosje geografike etj.; ose rasti i përdorimit të fjalëve të përngjitura që nuk kuptohet se për ç'arsye ndahen me vizë në mes p.sh. tetë-orësh, vetë-respekt etj.

Si përfundim është meritë e përkthyesve Mentor Petrela dhe Florian Dashi përzgjedhja e një libri të tillë që ka pasuruar serinë e kujtimeve të njerëzve të shquar në bibliotekën e librit shqip. Një përpjekje e suksesshme e mjekëve përkthyes, (kush do ta bënte më mirë se ata që janë specialistë të së njëjtës fushë me autorin e librit) duke u përpjekur të zbulojnë dhe të sjellin shqip një karakter të veçantë në një fushë interesante për lexuesin shqiptar, pavarësisht vërejtjeve për përsosmëri që ndoshta mund t'i shërbenin një ribotimi.

Opinion *i* Ditës

Një protestë e sakrifikuar në altarin e "17 majit"

Nga Erl Murati

(vijon nga faqja 1)

...lëshojë pushtet ndaj opozitës sipas modelit "ca bashki t'i drejtojmë ne, ca ata". Por, Spiropali vetëm e lajthitur nuk është, prej pak javësh ajo u emërua ministre dhe mban postin e zëdhënës së qeverisë, pra është zëri direkt i Edi Ramës.

Kjo "ofertë" e Ramës 24 orë para protestës mund të ketë qenë diversion ndaj opozitës. Por, në dritën e zhvillimeve të sotme, ajo shëmbëllen më shumë me një kampion alarmi. Dhe "alarmi" është, mos është marrë peng opozita në këtë vend?

Lulzim Basha ka disa javë që mobilizon popullin për "protestën më të madhe që ka parë ndonjëherë Shqipëria", siç thotë ai, apo për protestën ku "populli merr në dorë fatet e tij" apo ca më keq, ku "shqiptarët do të rrethojnë Kryeministrinë". Ai përsëriti se opozita nuk do të tërhiqet derisa të arrijë qëllimin: qeveri transitore, pa Edi Ramën, që do të garantonte zgjedhje të lira e të ndershme.

E pra, në orën e pestë të protestës, me bilancin e xhamave të thyer, kërpuhës së prishur, skelës së shembur dhe syve të lotuar nga gazi lotsjellës, ajo që u paralajmërua si demonstratë pa kthim, mori fund.

"Herën tjetër...", kërcënuan krerët e opozitës para kamerave.

Po herën tjetër, sepse këtë herë opozita vendosi të zbatojë lejen e policisë, protestuesit u rreshtuan para Kryeministrisë dhe jo në krah të saj, siç ishte paralajmëruar në rrethimin e famshëm.

E pra, unë nuk besoj se opozita s'ka fuqi të rrethojë Kryeministrinë apo se krerët e protestës u bënë papritmas "burra shteti", që zbatojnë rregulloret e Sandër Lleshajt.

S'dua të keqkuptohem: ky shkrim nuk është zhgënjim për "dhunën e pamjaftueshme", përkundrazi. Dhuna është krim dhe ajo nuk duhet relativizuar apo glorifikuar në asnjë rast.

Por, populli thotë: O fol e mba, o...

Nëse ke paralajmëruar qëndresë, qëndresë duhet të bësh. Studentët u thanë në të ftohtin e dhjetorit dhe pavarësisht se ca thonë "protesta dështoi", qëllimin e arritën. Kërkuan anulim tarifash, fituan përgjysmim tarifash. Pra, sakrifikuan, por nuk dolën duar-bosh.

Pse kujtoni se bërtisnin sot "Berisha -Berisha" militantët e PD? Mos i mori malli pas 6 vitesh për Doktorin? Aspak, por ata refuzojnë mënyrën "të rihit e mos e këput" të të bërit opozitë nga Lulzim Basha.

Ka gjasë që kumti i Spiropalit "ca bashki ne, ca ata" të mos ketë



qenë diversion, por një konfirmim i hijes së zezë të mesnatës së 17 majit 2017, ku Edi Rama dhe Lulzim Basha u mbyllën për orë të tëra, kokë më kokë, për të vendosur fatin e zgjedhjeve të ardhshme.

Dihet përfundimi i marrëveshjes: bashkëqeverisje, pra ndarje pushteti në tavolinë.

Andaj unë e shoh si kulminacion të filozofisë së 17 majit, emërimin e Bodes në BSH, emërimin e Bregut në RC, emërimin e gardistëve të 21 janarit në PS, rikthimin e drejtorëve të kohës së Berishës në krye të Poli-

cisë së Shtetit, promovimin e negociatorëve të paktit famëkeqë deri nga kjo qeveri, ruajtjen e bizneseve të përbashkëta nëpërmjet oligarkëve të përbashkët, etj.

Kohë pas kohe, njerëz të ndryshëm politikantë ose jo, kanë hedhur dyshime se ky pakt famëkeq vazhdon, se Rama dhe Basha pavarësisht teatrit me vezë dhe bojë ditëve të enjte, ruajnë komunikimin mes tyre. Këtë e pohoi edhe kryeministri Rama 3 javë më parë. Ditën kur i tha Berishës "a e kalon dot Atlantikun", midis rreshtave ai u drejtua Bashës "se ne komunikojmë..."

E pra, nëse Rama dhe Basha komunikojnë, ata nuk e bëjnë se janë shokë fëmijërie, klase e lagjeje, nuk e bëjnë se i lidh profesioni e pasioni. Ky komunikim është një thikë në shpinën e demokracisë, ku popullit i serviret një teatër kinse pluralist dhe në fakt, pluralizmi sakrifikohet në altarin e një duopolit politik, ku rotacioni ndodh në tavolinë e ku pushteti i radhës kujdeset për shëndetin, pasurinë dhe mosprekjen nga drejtësia të opozitës së radhës.

Teatri vazhdon, të gjithë flasin në emër të popullit dhe i vetmi që e ha në fund është populli.

HOROSKOPI

DASHI

Ju duhet të përballeni me faktet dhe të zgjidhni problemet sa më shpejt që mundeni. Kjo është mënyra e vetme që ju mund t'i tejkaloni ato. Injorimi i realitetit të situatës nuk do t'ju ndihmojë.

DEMI

Sot mund të karakterizoheni nga shumë energji krijuese, që ju bën të aftë të realizoni disa detyra të rëndësishme. Shprehni ndjenjat tuaja ndaj një personi që e pëlqeni prej kohësh.

BINJAKET

Kujdesi për miqtë tuaj dhe problemet e tyre ju bën një mik të mirë, por a janë prioritetet tuaja duke ndryshuar? Sot mendoni më shumë për gjërat që doni të ndryshoni në jetën tuaj. Në dashuri do të merrni lajme të mira.

GAFORJA

Sot do të karakterizoheni nga një ndjenjë optimizmi që ju bën t'i shikoni edhe të panjohurit si miq të afërm. Në çështjet e parave priret të merrni lajme të mira dhe investimet do të jenë të favorizuara.

LUANI

Ndërsa jeta juaj fillon të lidhet me dikë tjetër, ju mund të ndjeni një ndjesi gjithnjë e më mirë përgjegjësie ndaj këti personi. Ju dhe natyra juaj bujare dhe e dhembshur dëshironi ta kontaktoni dhe ta ndihmoni atë që të bëjë rregullimet e nevojshme.

VIRGJERESHA

Me të gjitha kurthet që ju keni evituar kohët e fundit, a nuk mendoni se ka ardhur momenti që të organizoni një festë? Tërhiquni nga rutina juaj e përditshme dhe krijoni një ditë të veçantë sot.

PESHORJA

Skena është gati për debutimin tuaj. Njerëzit që ju rrethojnë janë dashamirës ndaj jush dhe për këtë arsye nuk duhet të shqetësoheni për të bërë një përshlyetje të mirë. Me paratë tregoni më shumë vëmendje.

AKREPI

Njerëz jo të zgjarë që thonë gjëra të pakuptimta do të jenë të gjithë rreth jush sot, duke ju bërë të ndiheni të argëtuar dhe jashtëzakonisht inteligjent gjatë gjithë ditës. Kjo ndjenjë e superioritetit mund të jetë një mjet i dobishëm në të gjitha ndërveprimet tuaja.

SHIGJETARI

Përpiguni të argëtoheni më shumë dhe të lini pas shqetësimit. Sot dita juaj do të jetë e mbushur me informacione të rëndësishme, që nëse i trajtoni siç duhet, mund të ndryshojnë jetën tuaj.

BRICJAPI

Ju e dini se çfarë po bëni, prandaj mos hezitoni të merrni kontrollin dhe t'i shtyni gjërat në drejtimin e duhur. Fakti që ju i inkurajoni opinionet e njerëzve të tjerë është një nga cilësitë tuaja më të forta, por duhet të dini të vendosni një kufi.

UJORI

Dikush i afërt me ju prej një kohe të gjatë premon se do të ndryshojë, por ju nuk keni parë shumë prova për këtë deri sot. Në dashuri ndjeni një lloj zhgënjimi, por me pesimizëm nuk mund të sillni ndryshim pozitiv.

PESHQIT

E gjithë vëmendja pozitive e miqve ju bën të ndiheni mirë, por mos lejoni që kjo t'ju bëjë arrogante. Në punë mund të përballeni me disa probleme të vogla për shkak të disa personave që nuk ju

Opinion

i Ditës

Shuplaka që nuk erdhi nga studentët

Nga Fatos Çoçoli

... armësh humbëm 26 jetë. Më 21 janar 2011 humbëm 4 jetë. Dje, më 16 shkurt 2019 humbëm zero jetë! Dje fitoi vetëm Shqipëria. Opozita kryesore mbushi bulevardin qendror të vendit me njerëz në protestë. Kishte shumë jopartiakë në bulevard dje. Qytetarë që kanë humbur shpresën, orientimin, besimin, drejtpeshimin. Njerëz vërtet të dëshpëruar. Qeveria duhet t'i shohë këta njerëz të dëshpëruar. Ata janë aktakuza më e fortë për dështimet e saj në qeverisjen e vendit. Kjo qeveri ende nuk i ka dhënë vendit shpresë. Sikurse opozita kryesore e sotme që kemi, për fat të keq të të gjithë neve, nuk po u jep qytetarëve të thjeshtë shpresë për ndryshim. Qeveria nuk është e vërtetë se doli më e fortë. Edhe pse policia e përballoi me profesionalizëm sprovën ku ishte thirrur. Nëse qeveria do nisë të pompohet e të shfaqet si triumfuese sot e në ditët më pas, do të tallet dhe fshikullojë "dështimin" e djeshëm në përshkallëzimin e dhunës, do t'i bëjë "harakiri" vetes. Të jetë e sigurt për këtë. Do të prodhojë atë arrogancë që pas dy vitesh e gjysmë do ta largojë me siguri nga pushteti, pavarësisht opozitës amorfë të sotme që kemi. Qeveria duhet të shohë shuplakën që mori, kësaj here jo nga studentët. Shuplaka nuk qëndronte tek ata drejtues të opozitës, që nuk ngjallin shpresë jo më tek njerëzit e zakonshëm, por as edhe tek ithtarët dhe ndjekësit e partive të tyre. Shuplaka rrinte e fshehur te fytyrat jopartiake të djeshme në bulevard, që ishin me mijëra. Jo! Ata nuk ndodheshin aty të manipuluar. As



të indoktrinuar, as të hipnotizuar. Nuk shkonin si delet gorre pas cjapit partiak të hazdisur. Ishin aty për llogari të mjerimit që nuk po arrijnë ta shpëtojnë, ta heqin qafe si një zhele të vjetër, nga shpatullat e kërrusura. Ishin për sytë e shndritshëm të fëmijëve të tyre, që jo çdo ditë arrijnë të mbushin barkun plotësisht me bukë. Ishin për varfërinë e skajshme dhe mungesën e thekur të perspektivës, të shtruar këmbëkryq në vatrën


tyre. Dhe këtyre njerëzve kjo qeveri nuk ka çfarë tarifash studimi t'u përgjysmojë. Po, mund të bëjë shumë për ta, se u ka borxh mirëfilli shumë. Një mijë punë që deri tani nuk i ka bërë. Ja përse qeveria duhet të ndihet në faj dhe me turp sot nga ajo që pa dje në bulevard. Opozita ishte në të drejtën e saj dje, kur mori zemër dhe forcoi radhët, nga jopartiakët që pa. Duke fituar kurajë (i duhet vërtet shumë) për protesta të reja

(kuptohet, më të pakta në numër demonstruesish). Policia jonë më në fund tregoi standardin e munguar prej 28 vitesh tashmë, për vetëpërmbytje dhe kundërveprim profesional. Të lënduarit që të gjithë (protestues, policë dhe madje edhe gazetarë) u ndihmuan dhe u transportuan menjëherë në spital nga ambulanca që qëndronin pak metra larg zemrës së protestës. Gjithçka e organizuar mjeshhtërisht nga të dyja palët (protestuesit dhe

mbrojtësit e institucioneve shtetërore - struktura që na përkasin të gjithëve). Nuk u panë protestues të armatosur me armë vrasare, edhe pse disa syresh kishin dhe hodhën bomba molotov (shishe me lëndë djegëse). Policia që përballoi valën e protestuesve ishte e paarmatosur, sikurse kishin këshilluar me të drejtë ndërkombëtarët. Pyes për zotë të lajmëtarë të dhunës ditë më parë të protestës, dje gjatë saj dhe sot: çfarë do të thotë të çosh deri në fund dhunën e nisur; të shohësh në flakë që nga themelet godinën e Kryeministrit së vendit tënd? Kjo është të çosh deri në fund një dhunë të paralajmëruar dhe të filluar? Kjo është zgjidhja e kapjes së shtetit nga kjo qeveri e sotmja? Kështu do t'i zgjidhim hallat e qytetarëve tanë? Dje fitoi realisht e gjithë Shqipëria. Dje, edhe pse dhuna (me aq sa arriti të kryhej) mori kamerat dhe titujt e mediave perëndimore, gjasat e integritit dhe 'Posë së Brukselit për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në familjen e madhe evropiane, nuk morën një goditje fatale. Ishte një protestë e madhe e opozitës, me shashka, tym e gaz lotsjellës, si dhe pak shkatërrim prone publike, që mund të ishte zhvilluar po njësoj në qendër të Athinës, Romës apo edhe Parisit të batërditur nga protestat mujore të 'xhaketa të verdha'. Për të gjitha këto arsye, ndjeva ngazëllim brenda vetes dje, thjesht si qytetar, pse si qindra mijëra të tjerë kisha menduar me frikë për shumë më keq. Por nuk humbëm jetë njerëzish dje! Fituan një shuplakë të fortë jopartiake që do t'i bëjë mirë kësaj qeverie, po të arrijë ta dallojë dhe lexojë. Por vallë, a do të arrijë?



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Roland ... i një turneu tenistik.
6. Eshhtë përshtatja.
12. Lidhin brigje.
13. Eshhtë lëndë helmuese luftarake.
15. Binjakët në klasa.
16. Eshhtë rozë me gossip.
18. Ente Grumbillimi Tiranë.
19. Gjysma e sfidës
21. Rossi në MotoGp.
24. Qe përnindësh në labirint.
26. Gjysmë rebusi.
28. I famshëm ai i Anne Frank
29. Fillojnë tatëpjetën.
30. Ishte anestetik i parë.
32. Gjysmë ironik.
33. Bates që qe aktor.
35. Eshhtë sport me stil të lirë.
37. Poet i famshëm rus.
39. Luahen në teatër.
41. Një bluzë sportive.

42. Diftong poetik.
43. Tre në Arlington.
44. Sorel aktor
46. Me to bëjnë torta.
48. Janë gjaknxehtët.
52. Ekstre në lëng.
53. Mund të jetë franceskan.
54. I ndjeri Pascal i Pirandello-s

VERTIKAL

1. Hiddink trainer.
2. Mbyllin një sirtar.
3. Një pije e jona.
4. Rotor pa zë.
5. Mimar arkitekti i famshëm me origjinë shqiptare.
6. Kryejnë veprime pagesash.
7. Këndonte me Supremes.
8. Mbyllin fushatat.
9. Të fundit në shtëpi.
10. Intriganti i Otello.
11. Eshhtë shahu i fundit.
14. Manovron me cloche.
17. Ishte poeti i metamorfozave
18. Pak enigmatike.
20. Janë për të shkruar nxënësit.
22. I ka tek truri.
23. Inicialete e Reitman.
34. Ashtu si kërkon të blejë kopraci.
36. Një sportist në pistë.
38. Inicialet e Harris aktor.
40. Eshhtë mballomë.
45. Parafjalë prejardhjeje.
47. Fillojnë afrimin.
49. Në fillim të vitit.
50. Të fundit në proxim.
51. Fillojnë kalimin.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Përhapat me frikë.
6. Kreshniku i vëllejbolit.
12. Një mund të jetë unik.
13. Ekstre për naif.
15. Pak praktike
16. Mbyllin një manastir.
17. Vrau Hektorin.
20. I ka tek litri.
21. Një pjesë e gastareve.
23. Skudra e Bergamos.
26. Mund të jetë sitcom në Tv.
29. Janë porositë e fundit.
31. Gjysmë krenar
33. Një që jeton i vetmuar.
34. De Niro aktor.
37. Kufijtë e Tailandës.
38. Fund dhjetori.
39. Safin tenist.
40. Në fund majtas.
41. Demek s'ka kufij.

VERTIKAL


1. Fillojnë poshtë.
2. E famshëm ajo e Noes.
3. Fillojnë natën.
4. Tiran pa kufij.
5. Prishtë nga përçarja.
7. Me të nxjerrin një tapë.
8. Nuk duhet një e tillë.
9. Mbyllin porta.
10. Një mund të jetë fetar.
11. Opera e Mascagni-t.
14. Kanë gjuhë përvëluese
18. Eshhtë laps.
19. Pinci i Dy herë mat.
20. Janë të ndarë nga feja.
21. Qëllojnë me çifte.
22. Ylli në Hollywood.
24. Inicialet e Moravia-s
25. Inicialet e Dreiser.
27. Mund të jetë kinetike.
28. Gjysmë arrest.
30. Lionel, asi i futbollit.
32. Eshhtë hidrokarbur.
34. Në radhë të parë.
35. Janë topat katastrofikë të dëborës.
36. Janë pëlhura vere.
39. Mund të jetë solemne në kishë.
41. Braktisi Didonën.
42. Eshhtë legjenda.
44. Gjysmë alarmi.
48. Institucione Ndërkombëtare Ekonomike.
49. Inicialet e Redford.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

8			2	1		9		4
			2					6
7	5		4	9				3
						3		
			5			4	8	
				2	8		5	
6						5		
4		8						7
	7	9	1			2	4	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	7	2	9	5	6	8	4	3
9	5	4	3	8	7	6	1	2
6	8	3	2	1	4	9	5	7
2	9	1	5	6	3	4	7	8
5	6	7	4	2	8	3	9	1
4	3	8	7	9	1	5	2	6
7	2	5	6	3	9	1	8	4
3	1	9	8	4	2	7	6	5
8	4	6	1	7	5	2	3	9

Argëtim filozofik

- Ndonjëherë duhet të largohemi nga njerëzit. Nëse janë të interesuar, do ta vënë re. Nëse jo, do të dimë se ku jemi.

- Një nga momentet e lumtura të jetës është kur gjen fuqinë për të pranuar atë që nuk mund të ndryshosh.

- Paraja mund të blejë shtratit, por jo gjumin. Libra, por jo arsim. Robra të bukura, por jo financë. Argëtim, por jo lumtur. Njerëz, por jo njerëzimin.

- "Një përqafim i heshtur, është sa një mijë fjalë për një zemër të lënduar"

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

14	1	3	9	16	13	15	5	8	16	M	I	K	E	K	M	S	E					
5	14	5	3	5	4	7	10	2	8	4	2	E	K	A	R	O	M	A	K	E	T	
13	5	15	5	10	5	9	1	4	5	11	K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T	
1	15	2	10	1	4	2	15	1	6	1	M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	S	
15	7	14	2	4	1	1	18	3	1	4	P	A	S	A	N	I	K	T	A	R	E	T
1	16	2	4	4	5	9	1	5	4	4	R	E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T
10	5	17	H	2	6	5	3	8	5	4	R	E	T	E	E	I	R	A	N	I		
12	11	5	A	9	9	18	5	8	4	5	I	T	R	B	L	A	K	E	L			
3	4	15	K	1	4	4	4	4	4	5	13	M	I	A	R	E	D	E	K	I		
3	16	12	17	5	2	3	16	6	2	E	M	E	T	A	L	E	I	S				
1	10	11	5	13	15	5	3	2	1	9	T	E	K	E	M	K	U	M	T			
4	2	18	5	3	1	4	4	3	16	3	2	M	O	R	A	V	I	A	M	A	E	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A	
D	I	A	N	A	H	A	N	T	I	K		
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	S	
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T	L	E	
T	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E	
		K	E	N	E	T	A	O	R	A	R	
P	A	U	L	I	N	R	R	I				
A	K	E	O	T	A	A	D	D	I	M		
R	U	M	U	N	E	K	I	E	R	A		
E	T	J	I	T	E	R	I	A	M	A	N	
T	E	L	I	G	O	R	D	I	A	N	E	
I	N	T	A	R	O	M	A	T	I	T		
P	A	B	M	E	L	E	R	G	O			
R	K	U	P	A	E	M	I	R	A	T	E	
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T	
C	I	K	L	I	S	T	E	T				
S	T	A	D	I	U	M	E	T	A	P	E	L
D	I	K	A	S	T	E	R	E	R	U	E	
K	E	N	T	N	G	O	P	J	E	V		
K	A	T	I	A	S	I	E	S	E			
A	R	N	T	O	L	A	T	R				
M	A	S	S	I	M	O	Z	A	N	O	R	E
A	M	A	N	A	N	N	A	N	N			
T	I	E	R	R	E	N	I	E	T	N	E	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Zemra ka veshët e saj për të dëgjuar atë që mëndonja nuk e kupton.
- Ndonjëherë është më e lehtë të buzëqeshësh dhe të pretendosh se je i lumtur, sesa të shpjegosh pse nuk je.
- Kurrë nuk i kam përfillur ata që i kanë xhepat plot.
- Kur pashë zemrat e tyre bosh, u dhashë dhe 1 euro.
- Nuk je kurrë i mjaftueshëm...Për dikë që nuk di çfarë do.
- "Gjithmonë dikush do të jetë më i bukur. Gjithmonë dikush do të jetë më i zgjuar. Gjithmonë dikush do të jetë më i ri. Por, kurrë dikush do të jetë TI"

